

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6069  
E mërkurë, 22 korrik 2020  
çmimi 0.40 €

Udhëheqësit e BE-së  
merren vesh për buxhetin  
dhe paketën e rimëkëmbjes  
nga pandemia | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPINION

**RAPORTI I DICK MARTYT I  
NISUR SI PUNË E THJESHTË  
KA SJELLË NJË NDËRLIKIM  
ABSURD (13) F. 11**

Shkruan:  
Kudusi LAMA



## AKTUALE

**KUVENDI KOMUNAL I ISTOGUT  
DHE DRAGASHIT NXJERRIN  
DEKLARATË QË MBRON VLERAT  
E UÇK-së F. 10**

**AMBASADA E BRITANISË DHE E  
FRANCËS MOHOJNË SE KANË  
SHKËPUTUR KONTAKTET ME  
PRESIDENTIN THAÇI F. 7**

**LIROHET SADRI RAMABAJA,  
RASTI 'SYRI I POPULLIT'  
KTHEHET NË RIGJYKIM F. 6**

## EKONOMI

**PËRFUNDON ASFALTIMI  
I RRUGËS NË VETERNIK F. 9**

**KOSOVA, POTENCIAL I MIRË PËR  
TRAJTIMIN E INVESTITORËVE  
STRATEGJIKË F. 8**



## SPORT

**GJILANI DHE BALLKANI SOT  
LUFTOJNË PËR FITORE F. 16**

PARTITË OPOZITARE, LËVIZJA VETËVENDOSJE DHE PARTIA DEMOKRATIKE  
E KOSOVËS, E KANË BOJKOTUAR FORUMIN E PARTIVE POLITIKE TË  
THIRRUR NGA KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI PËR DIALOGUN ME SERBINË

## POZITA DHE OPOZITA, TË NDARA RRETH DIALOGUT ME SERBINË



As qeveria Hoti nuk po mund të arrijë një konsensus kombëtar për dialogun Kosovë - Serbi. Dallimet e pozitës dhe të opozitës për këtë proces janë shfaqur edhe të martën kur Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë refuzuar ftesën e kryeministrit Avdullah Hoti për pjesëmarrje në forumin e partive politike, në të cilin do të diskutohej për ecurinë e deritanishme të dialogut me Serbinë në Bruksel. Dy partitë opozitare kanë kritikuar qasjen e qeverisë ndaj këtij procesi, ndërsa partnerët e koalicionit i kanë dhanë mbështetje të plotë kryeministrit Hoti për procesin e dialogut politik me Serbinë | FAQE 4-5

## KOORDINATORI PËR DIALOG, 'PA MANDAT' PËR TË NEGOCIUAR NË EMËR TË KOSOVËS



Koordinatori për dialogun me Serbinë, të cilin e ka emëruar Qeveria e Kosovës të martën, nuk mund të jetë i efektshëm pa një legjitimitet nga i

gjithë spektrin politik në vend dhe, për më shumë, ai nuk ka mandat që të negociojë në emër të shtetit, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve

politike në Kosovë. Reagimet e tyre vijnë pas emërimit të Skender Hysenit në pozitën e koordinorit për dialogun me Serbinë nga Qeveria e Kosovës

Edhe pesë të vdekur dhe 168 të infektuar me Covid-19 në Kosovë

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Erdogani shtyn përpara planet për t'i vënë nën kontroll mediat sociale

ANKARA, 21 KORRIK - Partia në pushtet e presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan ka përgatitur një projektligj, përmes të cilit do t'i mundësohej qeverisë ta shtrëngohej kontrollin e saj

në mediat sociale, ka theksuar një zyrtar turk, raporton "Reuters". Projektligji pritet të shqyrtohet nga parlamenti gjatë javës së ardhshme. Opozita ka frikë se legjislacioni do të çojë në

censurë më të madhe në vend.

Me fillim të këtij muaji presidenti Rexhep Tajip Erdogan u zotua se do t'i vënë nën kontroll mediat sociale, pas pretendimeve se në rrjetin

social "Twitter", përmes disa postimeve, ishin fyer vajza dhe dhëndri i tij, pasi kishin njoftuar se u ka lindur fëmijë. Të paktën 11 persona u arrestuan dhe u morën në pyetje për këtë rast.



## Trumpi rikthen konferencat për koronavirusin

UASHINGTON, 21 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka pranuar se ShBA-ja është duke përjetuar një "höv të madh" të rasteve me koronavirus. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", numri i të infektuarve në ShBA ka arritur në mbi 3.8 milionë, ndërsa i viktimitave në 141 000.

Trumpi ka bërë me dije se do t'i rikthejë konferencat e përditshme për media të task-forcës së Shtëpisë së Bardhë "për t'i dhënë informacione publikut", nisur nga dita e martë. Ai, po ashtu, duket se ndryshoi qëndrimin ndaj veshjes së maskës, të cilën ka refuzuar ta miratojë si masë. Meqenëse nuk ka ende trajtim efektiv të koronavirusit, maskat shihen si një nga opsionet e pakta në dispozicion, që ndihmojnë në luftimin e përhapjes së virusit.



## Qeveria e Bullgarisë i mbijeton mocionit të mosbesimit



SOFJE, 21 KORRIK - Qeveria e qendrës së djathtë në Bullgari i mbijetoi votës së mosbesimit, proces i iniciuar nga socialistët opozitarë, të cilët e akuzojnë për dështim në luftimin dhe korrupsionin endemik. Votimi i së martës ishte mocioni i pestë i mosbesimit kundër qeverisë së koalicionit qëkur ajo ka marrë

detyrën në vitin 2017. Mijëra bullgarë kanë protestuar për gati dy javë kundër kabinetit të kryeministrit Boyko Borisov dhe kryeprokurorit Ivan Geshev. Disa qindra protestues u mblodhën jashtë parlamentit edhe para votimit të sotëm, duke brohoritur "Mafi", "Dorëheqje" dhe "Borisov është një turp".

Kundër mocionit votuan 124 ligjvënës, ndërsa për ishin 102. Borisov, 61 vjeç, po shërben mandatin e tretë si kryeministër. Sipas organizatës "Transparency International", Bullgaria është më e varfra dhe më e korruptuara nga 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Borisov javën e kaluar ka njoftu-

ar se tre ministra kryesorë, ai Financave, i Ekonomisë dhe i Punëve të Brendshme kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të dhënë dorëheqje në përpjekje për ta qetësuar zemërimin e publikut. Megjithatë, Borisov e ka shtyrë riorganizimin e kabinetit deri pas votimit të mocionit të mosbesimit.

## Dhoma e Përfaqësuesve në ShBA kalon ndryshimin e ligjit për armët bërthamore

UASHINGTON, 21 KORRIK - Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara ndaloi rifillimin e testimit të armëve bërthamore, duke miratuar një ndryshim në ligj.

Ndryshimi në Ligjin për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare, i cili ndalon përdorimin e çdo fondi për testimin e armëve bërthamore, u miratua me 227 vota për dhe 179 kundër. Masa duhet të miratohet edhe nga Senati Amerikan përpara se të shkojë te presidenti Donald Trump

për nënshkrim.

Shtetet e Bashkuara nuk kanë testuar armë bërthamore qysh në vitin 1992, edhe pse "Washington Post" ka raportuar në muajin maj se zyrtarët të lartë të administratës e kanë ngritur një mundësi të tillë.

Përfaqësuesja demokrate, Dina Titus, tha gjatë debatit se zyrtarët përgjegjës "nuk kanë identifikuar asnjë arsye teknike për ta rifilluar testimin bërthamor nëntokësor". Republikanët, megjithatë,


thënë se amendamenti ia lidh duart e ShBA-së, derisa vendet e tjera me armë bërthamore janë të lira t'i vazhdojnë provat. "Sa më të vështirë ta bëjmë, aq më pak e besueshme bëhet mbrojtja jonë. Sa më pak e besueshme që është mbrojtja jonë, aq më shumë kundërshtarët tanë do të përpiqen të përfitojnë nga ne", ka thënë përfaqësuesi republikan Mac Thornberry. ShBA-ja i ka kryer më herët testet e armëve bërthamore në Nevada dhe Nju Meksiko.





# Edhe pesë të vdekur dhe 168 të infektuar me Covid-19 në Kosovë

Në 24 orët e fundit në Kosovë janë shëruar 157 persona dhe kanë vdekur pesë të tjerë si pasojë e Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se të martën në vendin tonë janë paraqitur edhe 168 raste të reja me koronavirus, duke e çuar në 6 045 numrin e përgjithshëm të të infektuarave. “Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 157 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 3 226 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 675”, ka njoftuar IKShPK-ja



**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 21 KORRIK** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit në vendin tonë janë shëruar 157 persona të prekur nga Covid-19 dhe janë paraqitur 168 raste të reja. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë pesë persona të infektuar me koronavirus. “Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 415 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 168 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 6 045 raste nga 31 956 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 144 raste të vdekjes të cilët kanë

pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 157 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 3 226 raste e numri i rasteve aktive është 2 675”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të rasteve të reja me koronavirus. Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 91 raste, komuna Podujevë 11 raste, komuna Ferizaj 10 raste, komuna Deçan 8 raste, komuna Pejë 8 raste, komuna Fushë Kosovë 7 raste, komuna Gjakovë 7 raste, komuna Drenas 5 raste, komuna Obiliq 5 raste, komuna Malishevë 4 raste, komuna Mitrovicë 3 raste, komuna Prizren 2 raste, komuna Shtime 2 raste, komuna Vushtrri 2 raste, komuna Lipjan 2 raste dhe 1 rast nga komuna e Skenderajt”, ka njoftuar ky

institut. Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur apelin bërë qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t’i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. “Të nderuar qytetarë, virusi është kudo. Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve. Virusi vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e

mbyllura”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vendi është duke shkuar drejt një normaliteti të ri. “Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmit, të familjes, të fëmijëve, të fafesisit, të komunitetit, pastaj të të gjithë qytetarëve. Inspektoratet sanitare të AUV-it dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në

çdo rast të moszbatimit eventual të rekomandimeve të Institutit Kombëtar”, ka njoftuar ky institut. Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. “Nuk ka të drejtë askush ta rrezikojë jetën e të afërmit të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe moszbatimit të rekomandimeve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat. Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm. Ju lutem të keni kujdes, sepse ende ekziston rreziku i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve. Ne po punojmë për ju, andaj na ndihmoni pak që t’ju ndihmojmë shumë”, ka njoftuar IKShPK-ja.

## Ministri Zemaj ofron mbështetje për Komitetin e ShSKUK-së

**EPOKA ERE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 21 KORRIK** - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka marrë pjesë të martën në mbledhjen e Komitetit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) për menaxhim të situatës me Covid-19. Nga anëtarët e Komitetit është njoftuar në lidhje me punën dhe organizimin që ka bërë dhe po bën ky komitet për trajtim të rasteve të dyshuara dhe konfirmuara me Covid-19.

Gjatë takimit të komitetit, ministri Zemaj ka falënderuar të gjithë punëtorët shëndetësorë për kontributin e jashtëzakonshëm që po japin për trajtim të rasteve me Covid-19, duke ofruar përkrahjen e plotë nga Ministria e



Shëndetësisë për menaxhim të pandemisë dhe situatës së përgjithshme. “Jemi në situatë emergjente. Të jeni vigjilentë. Kërkoj që riorganizimi të bëhet si është më së miri në të gjitha klinikat dhe spitalet. Kam kërkuar që të ketë prioritet të

lartë punimi i mostrave të analizave për klinikat ku trajtohen rastet me Covid-19, si Klinika Infektive, Pulmologjia, Neurologjia, por edhe Mjekësia Sportive. Rastet nga spitalet e përgjithshme, po ashtu, janë urgjente dhe nuk do të pritet për

rezultate”, ka theksuar Zemaj. Sipas tij, gatishmëria dhe koordinimi duhet të jenë në nivelin më të lartë, kurse ka thënë se Ministria e Shëndetësisë do t’i bëjë edhe furnizimet e nevojshme në koordinim të plotë me të gjitha

institucionet.

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, e ka njoftuar ministrin Zemaj se, në bazë të raportimeve në nivel të klinikave të QKUK-së dhe spitaleve të përgjithshme, ka në trajtim mbi 500 pacientë të dyshuar dhe konfirmuar me Covid-19 të cilët janë duke marrë shërbime shëndetësore. Ai ka njoftuar në lidhje me zbatimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për riorganizim të hapësirave dhe stafit shëndetësor, me theks të veçantë për krijimin e hapësirave të reja për trajtim të rasteve të dyshuara dhe konfirmuara me Covid-19. Anëtarët e komitetit nga klinikat e QKUK-së kanë raportuar në lidhje me punën dhe organizimin në kuadër të klinikave të cilat i menaxhojnë.





PARTITË OPOZITARE, LËVIZJA VETËVENDOSJE DHE PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS E KANË BOJKOTUAR FORUMIN E PARTIVE POLITIKE TË THIRRUR NGA KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI PËR DIALOGUN ME SERBINË

# POZITA DHE OPOZITA, TË NDARA RRETH DIALOGUT ME SERBINË

As qeveria Hoti nuk po mund të arrijë një konsensus kombëtar për dialogun Kosovë - Serbi. Dallimet e pozitës dhe të opozitës për këtë proces janë shfaqur edhe të martën kur Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës refuzuan ftesën e kryeministrit Avdullah Hoti për pjesëmarrje në forumin e partive politike, në të cilin do të diskutohej për ecurinë e deritanishme të dialogut me Serbinë në Bruksel. Dy partitë opozitare kanë kritikuar qasjen e qeverisë ndaj këtij procesi, ndërsa partnerët e koalicionit i kanë dhanë mbështetje të plotë kryeministrit Hoti për procesin e dialogut politik me Serbinë

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 KORRIK - Pozita dhe opozita janë larg konsensusit për dialogun e Brukselit. Dy subjektet opozitare, Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), sërish kanë refuzuar ftesat e kryeministrit Avdullah Hoti për pjesëmarrjen në forumin e partive politike, ku është diskutuar për ecurinë e deritanishme të dialogut me Serbinë. Pavarësisht prej mungesës së partive opozitare në këtë takim, partnerët e koalicionit qeverisës i ka kanë

dhënë mbështetje të plotë kryeministrit për procesin e dialogut. Nëpërmjet një njoftimi për media, qeveria ka njoftuar se kryeministri Avdullah Hoti e ka njoftuar të martën forumin e partive politike për ecurinë e deritanishme të dialogut me Serbinë, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Me këtë rast, kryeministrit ka theksuar se ky proces duhet të përfundojë me normalizim të marrëdhënieve në mes dy vendeve dhe me njohje reciproke. "Kryeministri Hoti shtjelloi ecurinë e deritanishme të procesit të

dialogut, duke nisur që nga Samiti i Parisit, mbajtur më 10 korrik 2020 nëpërmjet video-konferencës, në të cilin morën pjesë presidenti Macron, kancelarja Merkel, përfaqësuesi i lartë i politikës së jashtme i BE-së, Borrel, përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun, Lajçak dhe presidenti serb Vuçiq, video-konferenca e datës 12 korrik 2020, në mes kryeministrit të Kosovës dhe Presidentit të Serbisë, e udhëhequr nga z. Borrel dhe z. Lajçak, deri te takimi i fundit me presidentin serb në Bruksel, që është mbajtur më datë 16 korrik

2020, po ashtu me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të lartë të BE-së", është thënë në njoftimin e qeverisë.

Kryeministri Hoti ka ritheksuar se i tërë procesi i dialogut do të jetë plotësisht transparent, ndërsa Kuvendi i Kosovës, forumi i partive politike dhe opinioni i gjerë në vend do të njoftohen hollësisht për secilin takim. "Nga ana e tyre, të gjithë përfaqësuesit e partive politike të vendit, të përfaqësuar në këtë forum, u dhanë mbështetje të plotë kryeministrit Hoti dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për procesin e dialogut politik me Serbinë", është theksuar në njoftimin e qeverisë.

I vetmi që ka folur pas këtij takimi ka qenë sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi. Ai ka thënë se në emër të këtij subjekti politik ka kërkuar nga Hoti që të kihet kujdes që Kosova të mos rrëshqasë në një dialog teknik. Sipas tij, kjo nënkupton zvarritje të zgjidhjes apo normalizim të


raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Nisma nuk mendon se duhet të ecet në atë rrugë, sepse jemi të sigurt se kemi të bëjmë me të njëjtin film që e kemi parë prej vitit 2011 dhe kemi të bëjmë me të njëjtët aktorë dhe regjisorë. Kosova ka nevojë për një dialog i cili do të zgjidhë shpejt dhe drejt raportin në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Sherifi.

**Opozita tregon arsyet e mospjesëmarrjes në forumin e liderëve**

Dy partitë opozitare kanë refuzuar ftesën e kryeministrit Hoti për këtë takim. Duke e kritikuar qasjen e qeverisë Hoti ndaj dialogut, LV-ja dhe PDK-ja përmes zëdhënësve kanë treguar arsyet e mosmarrjes pjesë në këtë takim.

Zëdhënësi i Lëvizjes Vetëvendosje, Përparim Kryeziu, ka deklaruar se nuk mund të ketë dialog me Serbinë pa zgjedhje të reja. "Kemi pranuar një ftesë për takim me liderë, së cilës, sikurse e kemi





bërë veçse të qartë, nuk do t'i përgjigjemi. Nuk mund të ketë dialog të mirëfilltë pa legjitimitet të ri përmes zgjedhjeve. Dialogu Kosovë - Serbi duhet të jetë i përgatitur mirë dhe me parime, e kjo qeveri, përveç që s'është legjitime dhe legale, nuk është as e përgatitur dhe as nuk ka parime për këtë dialog", ka deklaruar Kryeziu. Kurse zëdhënësi i PDK-së, Avni

Bytyçi, ka vlerësuar se qeveria Hoti ka shfaqur amatorizëm të skajshëm në çështjen e dialogut, duke shtuar se improvizimet e tilla meritojnë injorim. Duke treguar arsyet e mospjesëmarrjes në këtë takim, ai ka deklaruar se nuk mund të shkosh në Bruksel për dialog, i papërgatitur, pa plan e pa mbështetje të gjerë të spektrit politik, e pastaj të kthehesh në Kosovë për të organizuar kinse një forum të liderëve për këtë çështje. "Partia Demokratike e Kosovës sot nuk mori pjesë në takimin e ftuar nga z. Hoti për tri arsye: Ka munguar ftesa zyrtare nga kryeministri Hoti që qartëson formatin dhe qëllimin e këtij takimi. Takimet e tilla duhet të mbahen gjithmonë në hapësirat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, aty edhe ku e kanë vendin partitë politike parlamentare. Takimet e tilla nuk duhet të organizohen vetëm për të thënë se jemi duke u angazhuar për një temë të caktuar. Pra, eksperimentimi dhe improvizimi nuk kanë vend për tema të rëndësishme së madhe siç është dialogu final në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar Bytyçi në profilin e saj në "Facebook". Ai ka vlerësuar se PDK-ja ka qenë gjithmonë e gatshme dhe konstruktive në raport me temat e mëdha e me rëndësi të veçantë për Kosovën. Por, sipas tij, improvizimet e tilla janë për keqardhje dhe meritojnë me plotë të drejtë injorimin e PDK-së.

## Khavit Haliti: Forumi i liderëve, qesharak

Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Khavit Haliti, ka reaguar ndaj takimit që ka pasur kryeministri Avdullah Hoti me liderët e partive politike. Haliti përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka kërkuar nga Hoti që të sqarojë se çfarë është forumi i liderëve. "Z. Hoti, a mund ta sqaroni se çfarë është 'Forum i liderëve'? Kur është formuar dhe nga kush? Cilat janë kompetencat e këtij 'kuazi forumi'? A është kushtetues? Ky 'forum' a ka status institucional e kushtetues? Si caktohet statusi i liderit që merr pjesë në mbledhjet e këtij 'forumi'? A është miratuar ky organ qesharak nga Kuvendi i Kosovës? Apo jeni i interesuar ta përjashtoni sovranin e të merreni me 'pronarin', më falni me 'pronarët' e partive politike që deputetët e partive të veta i kanë vetëm si makineri votimi", ka shkruar



Haliti.

Ai ka kërkuar sqarim nga kryeministri Hoti për takimin në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Z. Hoti, raporto në Qeveri e Kuvend për atë që biseduat me Vuçiqin në Bruksel. Kjo është detyra juaj dhe obligimi juaj kushtetues. Njoftoje edhe presidentin. E me kryetarët e partive është mirë të bisedoni për ndryshimin e Ligjit për Zgjedhjet dhe ta përgatitni atë. Besoj se e dini se BE-ja, ShBA-ja dhe Britania e Madhe kanë insistuar dhe insistojnë që të bëhet ligji i ri zgjedhor", ka deklaruar anëtari i Kryesisë së PDK-së, Khavit Haliti.

# Koordinatori për dialog, 'pa mandat' për të negociuar në emër të Kosovës

Koordinatori për dialogun me Serbinë, të cilin e ka emëruar Qeveria e Kosovës të martën, nuk mund të jetë i efektshëm pa një legjitimitet nga i gjithë spektri politik në vend dhe për më shumë, ai nuk ka mandat të negociojë në emër të shtetit, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në Kosovë. Reagimet e tyre vijnë pas emërimit të Skender Hysenit në pozitën e koordinatorit për dialogun me Serbinë nga Qeveria e Kosovës

PRISHTINË, 21 KORRIK - Njohësi i zhvillimeve politike, Artan Muhaxhiri, thotë për Radion Evropa e Lirë se i gjithë procesi i dialogut deri më tash ka kaluar në mënyrë jotransparente dhe të paefektshme, kështu që është pak e pritshme që një koordinator t'i kompensojë të gjitha mangësitë e deritashme, të cilat, sipas tij, kanë qenë rezultat i mosbashkëpunimit nga i gjithë spektri politik. "Emërimi i një koordinatori është një akt i cili më shumë është formal sesa konkret, sepse është shumë pak e pritshme që një koordinator të jetë aq i efektshëm sa ta përfundojë marrëveshjen dhe t'i sublimojë të gjithë ata hapa që janë bërë deri më tash. Po ashtu, as momenti aktual nuk është aspak i përshtatshëm me spektrin politik të Kosovës, i cili është jashtëzakonisht i përçarë dhe nuk ekziston as edhe një përaftrim minimal që do t'i jepte një legjitimitet politik nga të gjitha partitë një ekipi të tillë, siç ka ndodhur në procesin e Vjenës apo më herët në atë të Rambujesë", ka thënë Muhaxhiri.

Ai ka shtuar se dialogu dhe koordinimi i tij nuk mund të

jetë punë vetëm për një individ, qoftë ai edhe Skender Hyseni, i cili, sipas tij, e ka një përvojë të konsiderueshme në politikën ndërkombëtare të Kosovës. Muhaxhiri ka vlerësuar se Kosova ka nevojë për një ekip shumë më përfaqësues, me legjitimitet shumë më të madh të përfaqësuesve të qytetarëve dhe të Kuvendit të Kosovës, si dhe përfaqësim më të madh në aspektin e ekspertizës nga profesionistë që do të mund të kontribuonin në dizajnimin e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë ashtu siç ka ndodhur edhe në Vjenë dhe në Rambuje.

Ndërkaq, politologu Ramush Tahiri beson se Kosova nuk ka nevojë për një koordinator për dialogun me Serbinë sepse bisedimet duhet të mbahen në një nivel të lartë politik dhe thekson se Kushtetuta e Kosovës përcakton qartë se procesi duhet të udhëhiqet nga qeveria, pra nga kryeministri i Kosovës. "Vetëm qeveria ka një mandat të negociojë në emër të shtetit dhe të nënshkruajë marrëveshje. Nuk mund të transferohen autorizime te një person tjetër, por me siguri Avdullah Hoti bëri

një kompromis me strukturat e LDK-së. Unë mendoj se ai rrezikoi pozitën e qeverisë sepse ka vetëm 61 vota. Nëse nuk ka mbështetjen e Partisë Demokratike të Kosovës në lidhje me dialogun dhe marrëveshjet e ardhshme, atëherë vështirë do të mbijetojë", ka thënë Tahiri për "Radion Evropa e Lirë".

Tahiri nuk sheh asnjë arsye për emërimin e një koordinatori për dialogun e Kosovës me Serbinë, duke theksuar se ai nuk mund të jetë mbi postin e ministrit dhe qeverisë. Hyseni pritet ta përfaqësojë Kosovën në takimin e së enjtes, ku pritet të bisedohet për personat e pagjetur, për personat e zhvendosur dhe për bashkëpunimin ekonomik. Siç ka thënë kryeministri Avdullah Hoti të hënën, koordinatori shtetëror do të punojë edhe në "draftimin e marrëveshjes finale për njohje reciproke". Paralajmërimet për rinisjen e dialogut teknik nuk u mirëpritën në Prishtinë ku, përveç partive opozitare, Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Demokratike të Kosovës, kjo ide u kundërshtua edhe nga Presidenca.





## Hoti dhe Jashari bisedojnë rreth kompleksit memorial 'Adem Jashari' në Prekaz

PRISHTINË, 21 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të martën në takim kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, me të cilin ka biseduar për koordinimin e

veprimeve, me qëllim të përballimit të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19, për pakon e qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe për projekte të ndryshme zhvillimore që

ndërlidhen me këtë komunë. Po ashtu, kryeministri Hoti dhe kryetari Jashari janë pajtuar për hapat e ardhshëm institucionalë për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.



## Ambasada e ShBA-së dhuron pajisje mbrojtëse për nxënësit që do t'i nënshtrohen testit të maturës

PRISHTINË, 21 KORRIK (ER) - Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka pranuar të martën një donacion me pajisje mbrojtëse (maska dhe dezinfektues) nga Programi për Ndihmë Humanitare i Komandës Ushtarake Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat do të përdoren për realizimin e testit të maturës. Me këtë rast, ministri Ramë Likaj ka falënderuar Ambasadën Amerikane e cila ka mundësuar një donacion të tillë për realizimin e një procesi të rëndësishëm për maturantët.

Ministri Likaj ka përmendur bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen e Ambasadës Amerikane në të gjitha fushat, por ka theksuar se një ndihmë e tillë është e mirëseardhur në këtë kohë të vështirë, kur po ballafaqohemi

me pandeminë Covid-19.

Edhe përfaqësueset e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, Majore Courtney Olson, shefe e Zyrës për Bashkëpunim në Mbrojtje dhe Deborah MacLean, zyrtare për marrëdhënie me publikun, të cilat kanë dorëzuar donacionin, u shprehën të lumtura që MASH-tit i është mundësuar ky donacion, në mënyrë që mësimit dhe nxënësit të jenë të mbrojtur gjatë realizimit të testit të maturës.

Donacioni përmban 21 mijë maska mbrojtëse dhe 3 800 dezinfektues për duar, të cilët do të shpërndahen nëpër qendrat e testimit gjatë realizimit të Provimit të Maturës Shtetërore 2020.



## Lirohet Sadri Ramabajë, rasti 'Syri i Popullit' kthehet në rigjykim



PRISHTINË, 21 KORRIK (ER) - Gjykata e Apelit e ka prishur vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, duke e kthyer në rigjykim çështjen penale të njohur si "Syri i Popullit". Kjo gjykatë ka vendosur t'i mbajë në paraburgim Avni Llumnicën dhe Murat Jasharin, kurse Sadri Ramabajën ta lirojë nga paraburgimi. "Departamenti Special i Gjykatës së Apelit vendosi që të pandehurit A. Ll. dhe M. J. të mbeten nën masën e paraburgimit derisa gjykata e

shkallës së parë të marrë vendim tjetër, ndërsa të pandehurit S. R. t'i ndërpritet menjëherë masa e paraburgimit dhe t'i caktohet masa e paraqitjes në stacion policor. Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë e, po ashtu, se është shkelur edhe Ligji Penal", ka njoftuar Gjykata e Apelit.

## Selimi priti në takim lamtumirës ambasadorin e Zvicrës, Jean Hubert Lebet

PRISHTINË, 21 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka pritur të martën në takim lamtumirës ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean Hubert Lebet, me rastin e përfundimit të misionit të tij diplomatik në Kosovë. Në takim me ambasadorin Lebet, ministri Selimi e ka njoftuar për çështjet që lidhen me angazhimet e tij si ministër i Drejtësisë, përfshirë reformën në drejtësi, sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit si dhe iniciativa të tjera të rëndësishme për sistemin e

drejtësisë të cilat janë në funksion të forcimit të shtetit ligjor. Ministri Selimi gjatë diskutimit me ambasadorin Lebet e ka falënderuar për gjithë angazhimin e tij gjatë këtyre viteve të shërbimit në Kosovë dhe ka shprehur mirënjohjen për mbështetjen e pandërprerë të shtetit zviceran dhe bashkëpunimin e çmuar që kanë në fusha ta caktuara duke vënë në pah edhe historinë e pasur të miqësisë dhe partneritetit mes dy vendeve tona.

Ministri Selimi ka theksuar se

Zvicra ka merita të veçanta në çdo gjë që është ndërtuar dhe arritur në Kosovë. Nga ana e tij, ambasadori Jean- Hubert Lebet e ka falënderuar ministrin Selimi për bashkëpunimin e ofruar dhe ka rikujtuar vendosmërinë e Ambasadës dhe shtetit zviceran për të bashkëpunuar dhe asistuar Ministrinë e Drejtësisë me çdo program mbështetjeje teknike edhe në të ardhmen për forcimin e kapaciteteve të Ministrisë në reformat e ndërmarra nga ministri Selimi.





# Ambasada e Britanisë dhe e Francës mohojnë se kanë shkëputur kontaktet me presidentin Thaçi



PRISHTINË, 21 KORRIK - Ambasada e Britanisë së Madhe dhe ajo e Francës kanë mohuar pretendimet e mediave se kanë ndërprerë komunikimin me presidentin Hashim Thaçi. Përmes njoftimeve për media, këto ambasada kanë vlerësuar se kanë kontakte të rregullta me të gjithë liderët e Kosovës, pa përjashtim. Ambasada e Britanisë së Madhe ka qenë e para që ka demantuar lajmin se "misionet e huaja në Kosovë, përfshirë edhe ato britanike, kanë bllokuar komunikimin me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, pas zhvillimeve të fundit të nxitura nga Prokuroria Speciale e Hagës". "Ambasada Britanike vazhdon që të ketë komunikim me të gjithë liderët politikë dhe institucionalë

në Kosovë. Kjo është diçka normale dhe esenciale për punën diplomatike të Ambasadës", është thënë në reagimin e Ambasadës së Britanisë së Madhe. Në këtë reagim është thënë se Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë nuk ka bllokuar komunikimin me asnjë prej liderëve politikë e institucionalë të vendit. "Si një partner dhe shtet mik i Kosovës, Britania e Madhe mbetet në kontakt me të gjitha institucionet e shtetit të Kosovës, me të gjitha partitë parlamentare, bashkë me qeverinë dhe opozitën. Ambasada nuk ka bllokuar komunikimin me asnjë lider politik apo institucional. Kushdo që thotë që diçka e tillë është bërë, ka gabuar", është thënë në reagim e kësaj ambasade.

Edhe Ambasada e Francës në Kosovë ka mohuar se ka bllokuar marrëdhëniet me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Njëpërmjet një njoftimi në llogarinë zyrtare në "Twitter", Ambasada e Francës ka bërë me dije se kontakte të rregullta me të gjithë liderët kosovarë, pa përjashtim. "Ambasada e Francës ka kontakte të rregullta me të gjithë liderët politikë dhe institucionalë dhe nuk 'bllokon komunikimin' me asnjërin prej tyre", është thënë në reagimin e Ambasadës së Francës. Këto ishin dy përgjigje ndaj raportimeve të mediave, se presidenti është izoluar nga misionet ndërkombëtare në Kosovë pas propozimatakuzës nga zyra e prokurorit e Gjykatës Speciale.

# Basha: Me koordinim të përbashkët mund të arrijmë përparim në proceset integruese

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në ditën e dytë të vizitës në Kosovë, ka takuar kryetarin e komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti dhe atë të Mitrovicës, Agim Bahtiri. Ai ka thënë se është me rëndësi jetike bashkëpunimi i ngushtë midis partnerëve strategjikë të kombit shqiptar, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në ditën e dytë të vizitës është takuar me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti, me të cilin ka diskutuar lidhur me situatën e shkaktuar nga Covid-19, por edhe për situatën politike, dialogun Kosovë - Serbi dhe aktakuzat e ngritura nga Prokuroria Speciale. Basha ka thënë se me Ahmetin janë marrë vesh për rëndësinë historike të dialogut me Serbinë, me qëllim njohjen

reciproke midis dy shteteve të pavarura ku, sipas tij, me rëndësi jetike është bashkëpunimi i ngushtë midis partnerëve strategjikë të kombit shqiptar, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian. "E garantova zotëri Ahmetin për një mbështetje totale për të gjitha vendimet e institucioneve dhe forcave politike të Kosovës. Vetëm përmes një qasjeje dhe koordinimi si ai që siguroi shpalljen e pavarësisë dhe njohjen e Kosovës nga shumë vende të botës do të mund të

bëjmë përparim në proceset integruese. Shërbimi më i mirë që mund t'i bëhet Kosovës në këtë kohë është heqja dorë nga protagonizmi i pavend, për konsum të brendshëm që, në fakt, e ka dëmtuar Kosovën", ka thënë Basha pas takimit. Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se kishte kënaqësinë ta presë në takim Lulzim Basha. "Diskutuum për situatën politike në Kosovë, Shqipëri e rajon dhe për proceset e rëndësishme dhe sfidat që po i kalojmë si shtet. Në këtë periudhë të vështirë, patjetër se na duhet një kohezion i faktorit politik shqiptar dhe ndihma e Shqipërisë është më e domosdoshme si asnjëherë më parë", ka thënë Ahmeti. Basha, pas Ahmetit, ka takuar kryetarin e Mitrovicës, Agim

Bahtiri. "I shpreha mirënjohjen zotëri Bahtirit për dimensionin kombëtar të qëndresës së tij, në emër të banorëve dhe qytetarëve të Mitrovicës, kundër copëtimit të Kosovës, plan i cili do të niste me copëtimin e qytetit të Mitrovicës. Në këtë kuadër, jam krenar që Partia Demokratike dhe unë personalisht, i jemi bashkëngjitur qëndrimin të drejtë të Kosovës për ruajtjen e tërësisë territoriale, si parakusht i vazhdimësisë së sovranitetit dhe pavarësisë së Kosovës, investime të lara me gjakun e bijve dhe bijave më të mira të Kosovës, investim i ShBA-së, BE-së e partnerëve euroatlantikë", ka thënë Basha. Ndërkaq kryetari Agim Bahtiri ka falënderuar përzemërsisht kryetarin e PD-së, për vizitën dhe interesimin e tij për qytetin

e Mitrovicës. "Kësaj radhe e kam pritur si kryetar të partisë, ndërsa në vitet në vijim do ta pres si kryeministër të Shqipërisë, për arsye se këtij vendi dhe populli i duhet një njeri që ia vlen të jetë shërbëtor i shqiptarëve. Gjithashtu, i shpreh mbështetje të fuqishme për sfidat që do t'i pret dhe bashkërisht ne do të jemi që ky njeri evropian dhe i shkolluar në Evropë, të jetë në detyrën ku jo vetëm unë, por e dëshirojmë krejt Kosova", ka thënë Bahtiri. Lideri i PD-së, Lulzim Basha, të martën ka vizituar Kompleksin Memorial "Adem Jashari", kullën e Isa Boletinit dhe ka bërë homazhe edhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova. Basha një ditë më parë ka takuar udhëheqësit e institucioneve të Kosovës dhe liderët e partive politike.





# Kosova, potencial i mirë për trajtimin e investitorëve strategjikë



**PRISHTINË, 21 KORRIK (ER)** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Odës Tregtare Kosovare-Turke, të kryesuar nga Abdurrahman Balkiz, kryetar i kësaj ode. Fillimisht, ministri Krasniqi i ka falënderuar mysafirët për përkushtimin e treguar për të bashkëpunuar edhe më tej në aspektin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Turqisë.

Ministri ka potencuar se ky bashkëpunim i ndërsjellë në mes të dy vendeve do të

vazhdojë edhe në të ardhmen si dhe to të thellohen edhe më shumë mundësitë investive dhe bashkëpunuese në mes të bizneseve të Kosovës dhe të Turqisë, e që do të ndikojnë edhe në zhvillimin e gjithëmbarshëm ekonomik të të dy vendet.

Ky bashkëpunim, sipas ministrit Krasniqi, "do të jetë edhe më i frytshëm nëse arrijmë që t'i eliminojmë barrierat gjatë shkëmbimeve tregtare ndërmjet dy vendeve, meqë kemi edhe marrëveshjen e nënshkruar për tregti të lirë në mes Kosovës dhe

Turqisë, e cila i jep mbështetje shkëmbimeve tregtare në mes të dy shteteve".

Ndërsa kryetari i Odës Tregtare Kosovare-Turke, Abdurrahman Balkiz, në fillim e ka uruar ministrin për pozitën e Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë dhe më pas i ka ngritur disa çështje që do ta ndihmonin biznesin nga të dyja anët. Ai e ka shtruar çështjen e mundësisë së investimeve turke në Kosovë, mundësinë e përgatitjes së produktit me vend të origjinës nga Kosova, si dhe mundësitë e ofrimit të

marrëveshjeve ekonomike në mes të afaristëve kosovarë dhe atyre turq.

Ministri Krasniqi ua ka sqaruar përfaqësuesve të Odës Tregtare Kosovare-Turke se Kosova tashmë është si potencial i mirë për trajtimin e investitorëve strategjikë, ku çështjen e investitorëve strategjikë e kemi të rregulluar edhe me Ligjin për Investime Strategjike, që mundëson lehtësira dhe mundësi investuese për investitorët e mundshëm strategjikë.

Si mundësi tjetër në fushën e

investimeve në Kosovë, ministri ka përmendur edhe zonat ekonomike që janë me interes ekonomik dhe se së shpejti do të jenë edhe si zona ku do të përqendrohen mundësitë investuese edhe nga investitorët më të vegjël, por që pritet së shpejti të rregullohen edhe disa çështje në aspektin e plotësimeve ligjore. Krejt në fund, ministri Krasniqi u ka bërë thirrje të gjithë investitorëve të mundshëm të Turqisë, që të vijnë t'i shikojnë mundësitë investuese që i ofron Kosova për investitorët në përgjithësi.

## Votohet kundër uljes së akcizës për pijet joalkoolike

**PRISHTINË, 21 KORRIK (ER)** - Anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Transfere kanë votuar kundër uljes së akcizës në lëngje nga 0.045 cent për litër në 0.005 cent për litër.

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, në fillim të takimit ka thënë se kjo ka qenë kërkesë e bizneseve të cilat merren me prodhimin e lëngjeve, duke shtuar se kjo po bëhet për shkak të goditjes së tyre nga pandemia Covid-19. "Qeveria ka marrë vendim për ndryshimin e tatimit të akcizës në lëngje dhe automjetet hibride. Sipas kërkesës së bizneseve, akciza 0.045 cent në lëngje është shumë e lartë. Ministria e Financave propozon që të zbritet në 0.005 cent në litër. Ndikimi financiar për këto dy është 5 milionë euro në vit për lëngje dhe 11 mijë euro për vetura", ka thënë Bajrami.

Por, lidhur me këtë, anëtarët e Komisionit shprehën rezervat e tyre për shkak të ndikimit që mund të ketë kjo në buxhetin e shtetit.

Deputeti nga radhët e PDK-së, Bedri Hamza, ka rekomanduar për kujdes për shkak të uljes së taksave. "Ne duhet të kemi kujdes për gjetjen e ekuilibrave për të mos i dëmtuar të hyrat", është shprehur ai.

Kurse Hekuran Murati nga LV-ja ka thënë se ndihma për prodhuesit vendorë duhet të ekzistojë, sidomos në këtë kohë. Deputetët kërkuar që qeveria të japë opsione të reja sa i përket kësaj çështje duke i ndihmuar prodhuesit vendorë.

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, më herët kishte njoftuar se ka propozuar që të ulet norma e akcizës për lëngjet dhe për veturat hibride.





# Udhëheqësit e BE-së merren vesh për buxhetin dhe paketën e rimëkëmbjes nga pandemia

**BRUKSEL, 21 KORRIK** - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian (BE) të martën u morën vesh për një buxhet shtatëvjeçar prej një trilion eurosh për BE-në dhe një paketë për nxjerrjen nga kriza të vendeve të goditura më rëndë nga Covid-19 prej 750 miliardë eurosh.

Fondet për luftën kundër koronavirusit do t'u ndahen vendeve më të goditura në formë kredish dhe grantesh. Marrëveshja pasoi katër ditë e katër net diskutime të zgjatura gjatë të cilave pika qendrore ndarëse ishte mospajtimi i disa prej vendeve më të pasura, përfshirë Holandën dhe Austrinë, që kërkonin kontroll më të rreptë të shpenzimeve, ndërsa të tjerët si Spanja dhe Italia kërkonim zvogëlim të kufizimeve.

Në fund udhëheqësit arritën një kompromis që 390 miliardë euro të ndahen si grante të pakthyeshme, ndërsa 360 miliardë të ndahen si kredi me

kamata të ulëta.

Kryeministri holandez Mark Rutte e cilësoi marrëveshjen "një paketë e mirë që mbron interesat e Holandës dhe që do ta bëjë Evropën më të fortë".

Kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se kanë hedhur themelet financiare për BE-në për shtatë vjetet e ardhshëm. "I dhamë një përgjigje kësaj krize, ndoshta më të madhes të Bashkimit Evropian", ka deklaruar Merkel.

Presidenti francez Emmanuel Macron e cilësoi "ditë historike për Evropën".

Parlamenti Evropian duhet ta miratojë marrëveshjen.

Vendet e BE-së kanë konfirmuar 135 mijë vdekje nga Covid-19, me Italinë, Francën dhe Spanjën, që radhiten në mesin e vendeve me numrin më të lartë të viktimave në botë. Mbyllja e detyruar nga shumë qeveri për ta frenuar përhapjen e virusit ka dëmtuar ekonominë e BE-së dhe ekonomistët parashikojnë një turrje prej 8.3-përqindësh.



## Përfundon asfaltimi i Veternikut, ministri Abrashi paralajmëron investime të reja

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 21 KORRIK** - Ministri i Infrastruktura, Arban Abrashi, ka vizituar të martën përfundimin e punimeve në zgjerimin e rrugës nacionale N2, segmenti hyrja në qytetin e Prishtinës, nga ana e Veternikut.

Ministri Abrashi ka theksuar se kjo rrugë është e rëndësishme për Prishtinën, pasi rregullimi i saj dhe zgjerimi do ta ndihmojnë funksionimin më të mirë të komunikacionit. "Ky projekt, ku brenda ditës kalojnë dhjetëra mijëra vetura, tani po merr edhe formë, pas një investimi të madh dhe tejet të rëndësishëm për Prishtinën. Sot po e hapim për qarkullim këtë pjesë të rëndësishme të rrugës së Veternikut në mënyrë



që të ofrojmë kushte më të mira për qytetarët e Kosovës dhe të

Prishtinës, pas një periudhe të gjatë të punimeve. Ne do të

ndërhyjmë edhe në pjesën tjetër, që kjo rrugë me katër

korsi. Për këtë rrugë do të shtrohet edhe një shtresë e re e asfaltit", ka thënë ministri Abrashi.

Ai ka shtuar se kjo rrugë do të jetë arterie kryesore për kryeqytetin, duke paralajmëruar se në këtë pjesë do të bëhen investime të reja. "Pas një periudhe shumë të gjatë dhe pas disa viteve pritje që të kryhen disa pjesë teknike, do të marrë formë të shkëlqyer. Do të ndërhyjmë edhe në pjesët e tjera për asfaltim në dy korsitë e tjera. Inxhinierët e ministrisë janë duke punuar për ndërtimin e një ure e cila do ta lidhë lagjen Kalabria me lagjen e Spitalit, por që janë projekte afatmesme e që kemi filluar t'i projektojmë", ka deklaruar Abrashi.

Ky projekt që ka përfunduar e ka edhe trotuarin dhe shtegun për çiklistët.

## Veliu, takim me drejtorin e KEDS-it, temë diskutimi siguria dhe klima e të bërit biznes

**PRISHTINË, 21 KORRIK (ER)** - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka pritur të martën në takim drejtorin e përgjithshëm të KEDS-it, Alper Erbas, me të cilin ka diskutuar për situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë. Me këtë rast, ministri Veliu ka theksuar se siguria e përgjithshme në

Kosovë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në klimën e të bërit biznes në Kosovë dhe prurjen e investitorëve të huaj. Ai ka thënë se institucionet e sigurisë janë duke bërë punë të shkëlqyer për të garantuar secilin investitor në Kosovë. Po ashtu, u vlerësua bashkëpunimi i mirë në mes të Ministrisë së

Punëve të Brendshme dhe KEDS-it dhe u premtua që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen, në veçanti edhe me Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, për evidentimin e avarive të ndryshme dhe dëmtimet që mund të shkaktohen nga energjia elektrike.





## Ndërroi jetë veterani dhe eprori i ish-UÇK-së, Shpejtim Hazrolli



**MALISHEVË, 21 KORRIK (ER)** - Ka ndërruar jetë veterani dhe eprori i ish-UÇK-së, Shpejtim Hazrolli (1968), nga fshati Banjë i Komunës së Malishevës. Eprori Hazrolli ishte një prej luftëtarëve të parë i cili ishte rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjatë tërë luftës çlirimtare kishte treguar heroizëm të pashoq, si dhe ishte një organizator i jashtëzakonshëm, gjë të për të cilën edhe iu dha detyra e udhëheqjes në njësi të caktuara brenda organizimit ushtarak të UÇK-së. Veterani i luftës, Shpejtim Hazrolli, së bashku me tërë familjen dhe rrethin e tij ishin

pjesë e luftës çlirimtare, duke dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në luftë.

Familjen, miqtë dhe bashkëluftëtarët e komandant Shpejtim Hazrollit i kanë ngushëlluar, kryetari i komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryetari i degës së OVL të UÇK-së në Malishevë, Metush Kryeziu, nëndega e OVL të UÇK-së në Banjë, si dhe shumë bashkëluftëtarë e miq të Shpejtim Hazrollit. "Lajmi për vdekjen e Shpejtimit ishte një lajm i rëndë dhe i dhimbshëm që morëm mbrëmë në të gjithë, prandaj më lejoni që në emër të bashkëluftëtarëve dhe në emër të Komunës së Malishevës,

shpreh ngushëllime për familjen, për miqtë dhe bashkëluftëtarët e Shpejtimit. Kam pasur fatin dhe nderin e veçantë që të jem bashkëluftëtar me Shpejtimin, i cili ka qenë një luftëtar i jashtëzakonshëm, ka qenë një organizator i mirë në luftë dhe ka dhënë një kontribut të madh në çlirimin e vendit", ka thënë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në telegramin e ngushëllimit. Sipas Begajt, Shpejtimi gjatë tërë luftës qëndroi ballë për ballë me armikun, ballëhapur gjithëherë dhe doli fitimtar në luftë dhe shkoi faqebardhë prej kësaj bote, duke na lënë kujtime të paharruara.

## Mbahet dëgjimi publik me këshillat e fshatrave në Mitrovicë për buxhetin 2021-2023

**MITROVICË, 21 KORRIK (ER)** - Në vazhdim të planifikimit të buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet e hershme 2021-2023, Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik e Komunës së Mitrovicës ka mbajtur dëgjimin publik të radhës me përfaqësuesit e fshatrave. Ky dëgjim publik është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës dhe është udhëhequr nga drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ndërsa kanë marrë pjesë edhe nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, zyrtari kryesor financiar Adem Fazliu, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të fshatrave, OJQ-ve dhe qytetarë të lokaliteteve të ndryshme. Në takimin për planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm, nënkryetari Faruk Mujka ka falënderuar të pranishmit për

pjesëmarrjen e tyre dhe ka vlerësuar se është e rëndësishme që ata t'i japin kërkesat dhe sugjerimet e tyre në planifikimin e buxhetit. Po ashtu, nënkryetari Mujka potencoi se ky dëgjim është pothuajse më i rëndësishmi për komunën, pasi që ka të bëjë drejtpërdrejt me nevojat dhe kërkesat e banorëve të fshatrave dhe të lagjeve dhe, pavarësisht mundësive të kufizuara buxhetore, komuna do të përpiqet të gjejë hapësirë si çdoherë t'i realizojë kërkesat më prioritare të banorëve.

Zyrtari kryesor financiar, Adem Fazliu, ka bërë një prezantim të buxhetit, ku ka theksuar se për vitin 2021 buxheti i Komunës së Mitrovicës planifikohet të jetë 21,193,585.00 euro, ku granti i përgjithshëm do të jetë në shumën prej 7,241,010 eurosh. Ai ka shtuar se granti specifik



për arsim do të jetë 8,776,311 euro, granti specifik për shëndetësi 2,506,903 euro si dhe financimi për teatrin 169,386 euro. Ndërkaq përfaqësuesit e fsha-

trave gjatë diskutimit për projektet buxhetore për vitet 2021-2023 kanë paraqitur kërkesat e tyre për investime kapitale në infrastrukturë, ku kryesisht kërkesat ishin të

fokusuara në projekte që kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës, kanalizim, asfaltim të rrugëve në lagje, rregullim të rrugëve në fshatra, ndriçim publik si dhe projekte të tjera.

## Në Gjilan do të nisë faza e dytë e dezinfektimit hapësinor

**GJILAN, 21 KORRIK (ER)** - Komuna e Gjilanit ka nisur fazën e dytë të dezinfektimit hapësinor për të krijuar një ambient pa insekte të dëmshme dhe pengesë në jetën e qytetarëve të Gjilanit.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e cila menaxhon këtë projekt, ka konfirmuar se të gjitha përgatitjet janë bërë që faza e dytë të nisë të martën në mbrëmje nga ora 19:30 deri në orën 24.00 dhe do të vazhdojë për tri ditë me radhë. Gjatë kohës së dezinfektimit qytetarët lutën që t'i mbajnë dritaret e mbyllura, që mos të futen insektet brenda, e kujdes të veçantë duhet të kenë edhe bletarët të cilët rekomandohen t'i mbyllin bletët e tyre nga ora 19:30 deri në orën 05:00.

Dezinfektimi fillon nga lagja "Zabeli", përkatësisht nga kolektori ku zakonisht është burim i mushkonjave dhe insekteve të tjera, për të vazhduar përgjatë lumit Mirusha në të



dyja anët e tij deri në qendër të qytetit, po ashtu do të përfshihet lagja Reshat Ymeri, Dheu i Bardhë, Dardania, Arbëria, Bregu i Djegur dhe tërë lagjet e tjera të qytetit. Këtë vit janë të përfshira edhe zonat rurale ku ka potencial të lartë të zhvillimit të këtyre insekteve, sidomos rreth lumenjve të fshatrave Malishevë, Uglarë, Pogragjë, Dobërçan, Përlepnice, Livoq i Epërm, Livoq i Ulët, Cërnicë, Lladovë, Zhegër, Llashticë dhe Velekincë.

## Kuvendi Komunal i Istogut dhe Dragashit nxjerrin deklaratë që mbron vlerat e UÇK-së

**ISTOG, 21 KORRIK (ER)** - Kuvendi Komunal i Istogut ka votuar të martën deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës çlirimtare të UÇK-së. Për këtë deklaratë kanë votuar asamblistët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së, Iniciativa Qytetare (një), ata të LV-së kanë abstenuar, kurse një asamblist nga komuniteti serb ka votuar kundër. Kjo deklaratë është propozuar nga grupi i asamblistëve i PDK-së.

Një deklaratë të tillë në mbështetje të UÇK-së e ka votuar edhe Kuvendi Komunal i Dragashit. Kjo deklaratë është përkrahur nga të gjitha grupet e asamblistëve, me përjashtim të asam-



blistit të Vetëvendosjes. Deklarata në fjalë e vlerëson si të paprecedent dhe ka dënuar publikimin e njoftimit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar për aktakuzë ndaj dy liderëve kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, duke shprehur bindjen për pafajësinë e tyre.



# RAPORTI I DICK MARTYT I NISUR SI PUNË E THJESHTË KA SJELLË NJË NDËRLIKIM ABSURD (13)



Shkruan: Kudusi LAMA

Çdo punë nisur është thjeshtë. Ndërlikimet vijnë më vonë. Ashtu besoj se ka nisur edhe raporti i Dick Martyt. Këshilli i Evropës, kur ka kërkuar të bëhet një raport i tillë, shpresoj të mos i ketë menduar prapaskenat serbe që do të ndikonin të krijohej një situatë, çfarë është krijuar dhe çfarë problemesh po sjellë në Kosovë, mbi luftëtarët e UÇK-së, por dhe me shqiptarë që nuk e kanë dëshiruar çlirimin nga Serbia dhe çlirimin e konsiderojnë pushtim nga UÇK-ja.

Por Serbia i ka pasur të paramenduara të gjitha nivelet e arritjes së këtij projekti antishqiptar. Prej kur është gjetur një i dashuruar pas serbëve e Serbisë si zotëri Marty. Askujt vërtet besoj se nuk i ka shkuar ndërmend se do të arrihej të krijohej një situatë e tillë që të ngrinte në këmbë një opinion të tërë. Por, ja që në rrjedhën e ngjarjeve që po zhvillohen, shihet se deri ku mund të arrijë ambicia serbe.

Duket sikur ka nisur një punë të thjeshtë, por ka bërë një ndërlikim absurd. Sepse bën tentativë ta mbartë llumin e krimeve serbe për t'i hedhur mbi shqiptarët duke ua vënë firmën dhe vulën në emër të Evropës. Realisht në mënyrën si është shprehur në raport zotëri Marty, duket se në shpirtin e tij ka, përveç kundërshqiptarizmit, që është i pakuptueshëm, edhe racizëm; tentativë kriminale të veshur me kostumin e antikrimin. Duke u përpjekur të godasë jo thjeshtë individë, por gjithë ecurinë kombëtare shqiptare, pasi ai godet në radhë të parë shtetin e Shqipërisë, duke e konsideruar një shtet që, përveç të këqijave dhe dëmeve, nuk i paska sjellë gjë tjetër rajonit (se shqiptarët nuk kanë ndonjë vlerë për zotëri Martyn), Evropës, por edhe më gjerë. Ashtu sikurse nëpërmjet veprës së tij për mua monstruoze, Marty zhvlerëson plotësisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe luftën e saj të lavdishme; individët drejtues të kësaj ushtrie dhe institucionet udhëheqëse të saj dhe të luftës çlirimtare, që na sollën lirinë e këtyre trojeve, si dhe mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e të gjithë botës politike-ushtarake më moderne të kohës; pavarësinë e Kosovës që është rrjedha normale e kësaj lufte të diktuar për të shpërrur kolonizimin serbo-sllav. Por për

ta justifikuar gjithë këtë revansh kundërshqiptar, merret nisma për ta goditur edhe NATO-në e ShBA-në që, sipas zotëri Martyt, kanë bërë padrejtësi që kanë ndihmuar shqiptarët e pushtuar për ta fituar lirinë. Nuk di se si do ta kishte zgjidhur çështjen e shqiptarëve të pushtuar ky jurist i Evropës, që i duket padrejtësi pse ata janë çliruar dhe mundohet me të gjitha shpifjet mafioze t'i quaj të padenjë për të qenë të lirë. Gjithë kjo lojë fjalësh, i titulluar raport në emër të Evropës, nuk duhet lejuar ta përdhosë qytetarinë evropiane. Unë e di se Evropa nuk ka kohë të merret me thashetheme dhe shpifje të nivelit më të ulët të mundshëm, si në raportin në fjalë, që realisht është gatuar në Beograd, me autorësinë legale të një njeriu të shitur, të veshur me rrobën e Evropës. Me këtë raport, duket se Evropa, duke e vlerësuar si diçka të thjeshtë, ka rënë në kurthin e monstruozeve. Unë nuk jam kundër raportit të Këshillit të Evropës, as kundër hulumtimit për përpilimin e një raporti të tillë, por për përpilimin e raporteve të tilla ka disa parime vlerash të cilat janë: Parimi i barazisë; parimi i të drejtës; parimi i qytetarisë; parimi i transparencës; parimi i ndershmërisë; parimi i etikës; parimi i profesionalizmit; parimi i detyrës; parimi i arsyes; parimi i humanizmit; parimi i argumentit etj. Zbatimi i këtyre parimeve nuk do ta kishte lënë zotëri Martyn të bënte një raport siç e ka bërë. Por, kur nuk merren parasysh parime të tilla do të zënë vend parime të tilla si: Parimi i shpifjes; parimi i zhvlerësimit; parimi i padrejtësisë; parimi i banditizmit; parimi i mafiozitetit; parimi i barbarizmit; parimi i pandershmërisë; parimi i kriminalitetit; parimi i revoltës; parimi i forcës etj. Do të bëhet raporti çfarë është bërë dhe do të zhvlehtësojë një komb të tërë për interesa personale të një Marty e për interesa kriminale të një pushtuesi dhe masakruesi, çfarë ishte dhe është Serbia për shqiptarët e trojet e tyre.

Jam i sigurt se në këto kushte e drejta do të triumfojë, por nuk kemi kohë për të humbur në betejë të tilla ne shqiptarët, pasi kemi shumë punë për ta ndërtuar jetën tonë, e po na imponohen edhe betejë të tilla që na bëjnë të humbim kohë.

Njëkohësisht kam shumë të qartë se Gjykata për Krimet e Luftës e UÇK-së, që shqiptarët e pranuan vetë pa hezitim, megjithëse personalisht jam kundër kësaj krijese, nëse do të mbështetet në parimet e vlerave, do ta ndëshkojë rëndë moralisht, politikisht dhe ligjërisht Dick Martyn dhe të gjithë ata që mendojnë e veprojnë si ai, përfshirë edhe Serbinë. Përfundimisht bota e civilizuar do

të kuptojë njëherë e mirë se cili është portreti i shqiptarëve dhe e drejta e tyre e do t'u japë atyre atë që u takon, duke i treguar vendin gjithsecilit që ka bërë përpjekje për ta njoollur atë portret në arenën ndërkombëtare.

Serbia i ka vrarë e shfarosur shqiptarët e pushtuar për një shekull të tërë, por atyre që kanë mendësi si zotëri Martyt nuk u bën përshtypje. Për ta me rëndësi është si t'i vrasin shqiptarët. Dhe vrasja nuk është vetëm kur ajo realizohet me armë, por edhe me dokumente të tilla si ky raport. Zotëri Marty nuk ka si i vret shqiptarët ndryshe se nuk i është dhënë mundësia, por në mënyrën e tij ai ka përdorur të gjitha llojet e armëve për t'i asgjësuar ata të gjithë. Dhe kjo është vrasje më masive se vrasja me armë, pasi krijon një ushtri shumë milionëshe që i besojnë raportit të tij në emër të Evropës. Qytetarët e botës që nuk kanë njohje për shqiptarët krijojnë bindje sipas deklaramëve të këtij raporti. Prandaj edhe shihet se Dick Marty me mentorët e tij serbë në Beograd e kanë shfrytëzuar mirë institucionin e Evropës për të bërë këtë monstruoze të madh kundërshqiptar.

Nuk më shkon mendja të mendoj se edhe një i dytë e ka ditur se çfarë do të kurdisë zotëri Marty me raportin e tij. Të gjithë ata që kanë pranuar të ngarkojnë me detyrë këtë zotëri, për të bërë këtë hetim e për të raportuar, e kanë vlerësuar me mendimin se ai duke qenë evropian ka ndershmërinë të bëjë diçka të ndershme dhe të sjellë ato të vërteta që mund të kenë ndodhur në Kosovë. Askush besoj nuk e ka ditur se një lëvizje e tillë do të ishte e kompozuar me kohë në Beograd dhe tani po caktohej vetëm një dirigjent formal, që do të sillte në atë organ të rëndësishëm evropian një raport që tashmë ishte i përgatitur me kohë. Raport i cili do të kishte për synim të rehabilitonte Serbinë dhe gjithë veprimtarinë e saj kriminale në Kosovë e viset shqiptarë të pushtuar dhe ta krijonte idenë se shqiptarët vetëm Serbia kishte mundur dhe mund t'i mbante nën sundim, pasi ata ishin të rrezikshëm.

Gjithnjë kam menduar se Evropa nuk mund të bjerë në kurthin e një individi nga radhët e saj, por kur është programuar pabesia, ja që edhe Evropa qenka delikate dhe mund të bjerë në kurth, siç ka rënë në kurthin e raportit të serbo-Martit.

Ndihem i habitur, si ka mundësi që një Këshill i Evropës të bjerë në një kurth të tillë dhe mos të arrijë të kuptojë se cila është lënda e parë për raportin në fjalë. Si ka mundësi që ata deputetë të atij parlamenti të nderuar të mos kenë kuptuar se gjithë ai raport mbështetet thjeshtë dhe vetëm thjeshtë në shpifjet e deklaruara me kohë të Serbisë, në dosjet e ndërtuara prej saj kundër shqiptarëve, në aktpaditë fiktive dhe në aktgjykimet e mbështetura në dëshmitarë pa identitet, në propagandën mediatike dhe në artin e ndërtuar me kujdes për Kosovën dhe shqiptarët. Si ka mundësi që këta parlamentarë nuk kanë mundur të kuptojnë se gjithçka është ndërtuar sipas parimeve të zbatuara prej Serbisë që gjatë luftës, kur denonconte dhe e klasifikonte botërisht luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si terroriste dhe kontrabandiste. Nuk mund të besoj se këta deputetë të Parlamentit të Evropës nuk kanë lexuar asgjë për këtë periudhë dhe nuk e kanë pasur të qartë se si është zhvilluar situata në ato treva të pushtuara. Që të mos jenë të sqaruar qytetarë të ndryshëm nëpër Evropë për zhvillimet politike-ushtarake të Evropës nuk më duket ndonjë gjë e çuditshme, por që parlamentarët e Evropës të mashtrohen kaq lehtë prej një kolegu të vet të shitur, që me veprën e tij e njooll emrin dhe reputacionin e të gjithëve, këtë nuk kam arritur ta kuptoj kurrë dhe nuk di a do ta kuptoj ndonjëherë.


Por kur kam lexuar se "...ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, ka shkuar deri në akuzën kolektive kundër shqiptarëve", duke u shprehur se "kjo është fytyra e vërtetë e Kosovës", bindem plotësisht se cili është qëllimi i gjithë këtij raporti që ka marrë autorësinë e Evropës. Vërtet qëllimi i këtij raporti tenton ta kriminalizojë fytyrën e Kosovës

dhe gjithë shqiptarëve. Nuk di a i lexon këto deklarata zotëri Marty, apo është edhe ai pjesë e përpilimit të tyre, pasi ka krijuar gjithë këtë ndërlikim, duke përfutur nga qytetaria evropiane, të cilën mendoj se e ka shfrytëzuar për ta ndyrë fytyrën e gjithë shqiptarëve, duke u përpjekur ta ndryjë shenjtërinë e tyre, luftën çlirimtare të Kosovës dhe luftëtarët e saj. Duket se duke bërë këtë raport kundërshqiptar, u ka dhënë Serbisë dhe autoriteteve politike e ligjore serbe të drejtën të bëjnë deklarata të tilla që e komprometojnë atë dhe krijojnë një situatë që është e çuditshme pse nuk e kuptojnë evropianët, pasi nuk dua të besoj se është dëshira e tyre ta krijojnë pikërisht këtë situatë komprometuese për veten, kur besoj se edhe ata lexojnë të tilla informacione publike si: "Ndërkaq prokurori i Serbisë ka deklaruar se institucioni i tij ka shkëmbyer të gjitha informacionet e nevojshme me Dick Marty, duke dëshmuar se është njëkohësisht autori kryesor i aktakuzës politike kundër Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi. Madje dosja e prokurorisë serbe rreth këtyre akuzave përmban jo pak, por 40 mijë faqe".

Të pranosh të bashkudhëtosh me një deklaratë të tillë, kur komprometohet plotësisht raporti në fjalë dhe ta quash atë të ligjshëm, duke parë ditën për diell, se nuk je tjetër veçse një koalicion bashkëpunëtorësh të politikës dhe prokurorisë serbe, duket si një lojë, që vërtet të krijon një shije të hidhur. Prej kësaj lind pyetja: vërtet Këshilli i Evropës kur i ka ngarkuar detyrën Dick Martyt për t'i gjetur krimet e bëra nga UÇK-ja, a e ka ditur se po bënte një lojë absurde komprometuese, apo vërtet e ka ditur se do të jetë diçka e thjeshtë që do të sqarojë disa paqartësi? Këtë përgjigje mund ta japin vetëm parlamentarët evropianë, por duket sikur diçka e kurdisur, që është ditur do të sillte një gjellë helmuese për të gjithë shqiptarët dhe me shije të veçantë për Serbinë dhe kriminelët e saj që kanë vepruar mbi shqiptarët me të gjitha torturat dhe masakrimet mesjetare. (Vijon)







## Mendja e fuqishme e John Stuart Mill-it

Nga: Selami XHEPA

“John Stuart Mill (1806-1873) – ishte John Stuart Mill”, shkruan Schumpeter, “domethënë, një nga figurat më të fuqishme intelektuale të shekullit të nëntëmbëdhjetë, dhe është aq i njohur për gjithkënd që është i arsimuar, sa duket e tepërt të përpiqesh të shtosh diçka më shumë nga sa mund të lexohet në një duzinë librash të shkruar për të.” (History of Economic Analysis, fq. 527). Në të vërtetë, janë me dhjetëra botime voluminoze të shkruara nga akademikë dhe mendje të fuqishme intelektuale, që nga Lord Ashley, tek Hayek, nga Hutchison tek Hollander, nga Spenser tek Rothbard – sa për të përmendur pak prej tyre – që kanë shqyrtuar veprën e Mill-it si ekonomist politik, si sociolog dhe filozof. Një burim i rëndësishëm reference për studiuesit është padyshim edhe “Vepra autobiografike” (voluminoze prej më shumë se 800 faqesh) e J. S. Mill-it, e cila i ishte dorëzuar librarisë së Universitetit të Columbia nga Helen Taylor, thjesht e Mill-it. Të flasësh për figurën e John Stuart Mill-it, duhet më së pari ta nisësh nga edukatori dhe mentori i jetës së tij, mendja po aq gjeniale dhe e fuqishme e James Mill-it, autori i veprës “Historia e Indisë britanike”, i ati i John-it. James Mill-it nuk ishte vetëm thjesht një dishepull dhe shok i Jeremy Bentham-it dhe David Ricardos-it; ai ishte një mendimtar i thellë dhe filozof origjinal. Ndikimi i

jashtëzakonshëm i të atit në formimin e tij, duket edhe nga mënyra sokratike e shkrimit të Autobiografisë. Shumë fëmijë kanë aftësi të jashtëzakonshme në fusha të caktuara, si në matematikë apo mësimet gjuhësh të huaja; John Stuart Mill i kishte të gjitha këto talente e, përveç tyre, kishte aftësi të jashtëzakonshme të rrokte që në moshën fëmijore ide abstrakte në ekonomi, filozofi e shkencat. Edukimi i Mill-it është pothuaj tërësisht i lidhur me të atin, James, shëtitjet në pyll me të cilin ishin ushtrimi intelektual dhe njëherësh klasa e tij e mësimet. Që në moshën trevjeçare kishte mësuar greqishten. Dhe, libri i parë grek që do të lexonte ishin Fabulat e Ezopit. Përpara se deri në moshën tetëvjeçare kur kishte mësuar edhe latinishten, ai kishte lexuar veprat e njohura të filozofit grek Ksenofonit, Anabasis, Kiropedia dhe kujtimet për Sokratin, jetën e disa prej filozofëve të antikitetit, si Diogjenit dhe Tuqididit; gjashtë dialogjet e Platonit. E vetmja gjë tjetër që kishte mësuar gjatë atyre viteve kishte qenë aritmetika. Detyrat dhe mësimet do t'i bënte në të njëjtën tavolinë pune, ku edhe vetë James shkruante librin e tij, “Historia e Indisë britanike”. Mësimet e vërteta nuk ishin orët e studimit në tavolinë, por shëtitjet e gjata të tyre në pyll dhe leximet e pavarura të veprave që i rekomandonte i ati. I pasionuar pas studimit të historisë, ai kishte patur afekcion për Historinë e Romës dhe Greqisë, libra e

historisë së Filipit të Dytë dhe të Tretë të Watson-it; ndërsa kur “rashë në kontakt me historinë e luftës për pavarësi të Amerikës, do të rreshtohesh në anën e gabuar, pasi kjo quhej ana e anglezëve”, do të pohonte tek Autobiografia. Diskutimet e tij të gjata filozofike ndërsa shoqëronte të atin në shëtitjet e gjata në pyll, dhe editimi i librit të Jeremy Bentham-it, “Racionalja e dëshmisë juridike”, akoma pa mbushur të njëzetat, janë dëshmi e jashtëzakonshme e një pjekurie të parakohshme. Në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, i ati do t'i jepte në duar veprën të Dumont-it, më të famshme në fushën e legjislacionit, “Traktat mbi legjislacionin”, që siç do të shkruante vetë J. S. Mill, “leximi i këtij libri ishte në vetvete një epokë në jetën time; një pikë kthese në historinë time mentale... Kur hodha mbi tryezë volumin e fundit të Traktatit, isha bërë tjetër njeri. Parimi i Utilitetit, i kuptuar siç e kuptonte Bentham dhe i aplikuar siç e kishte aplikuar ai në tre volumet e librit, kishin rënë në vendin e duhur, tamam si një nyje lidhëse që mbante të bashkuar komponentët fragmentar dhe të shkëputur të dijeve dhe besimeve të mia. I kishte dhënë unitet konceptimeve të mia mbi gjërat.” Në moshën trembëdhjetë vjeçare kishte kryer një kurs të plotë të ekonomisë politike! Në verën e vitit 1820, J. S. Mill do të shkonte në Francë dhe do të qëndronte për një vit e gjysmë në shtëpinë e Jean Baptiste Say-t, dhe pas kthimit në Londër, në moshën

22-vjeçare, do të futej në Zyrën e Indisë, ku i ati ishte shef. Edukimi do ta vazhdohte me leximet e eseve dhe diskutimet e debatet që do të zhvilloheshin një herë në dy javë në shtëpinë e Jeremy Bentham-it, ku ishte krijuar dhe mbledhjet që nga viti 1822-23 “Shoqëria e utilitaristëve”. Ky grup ku futeshin miqtë më të ngushtë të Mill-it, do të vepronin deri në vitin 1826, dhe aty do diskutonin çështje filozofike dhe do të shkruante artikuj dhe botonte një gazete me diskutimet e tyre (të cilat nuk janë gjendur). Në vitet 1826-27 ai do të kalonte një periudhë depresioni, deri në vitet 1840 kur do të përfundonte shkrimin e veprës “Logjika”. Në autobiografinë e vet ai i referohet kësaj periudhe si “vitet e tranzicionit”, vite që në fakt shënojnë një pikë kthese në aparatin e tij të mendimit dhe idetë e tij. Në këto vite të vështira, jo shumë të përmendura midis adhuruesve dhe pasueve të tij, ai do të gjente paqe tek poezia e Wordsworth dhe Shelly-t (e preferuara e mikes së tij të zemrës, Harriet Taylor), tek dashuria për muzikën dhe dëshirën në rritje për artet, dramën, pikturën dhe arkitekturën. Një influencim i fuqishëm në jetën e tij do të luanin njohjet e reja me rrethin e unitarianëve W. J. Fox, një orator i madh anglez politik dhe religjioz, dhe njohja me Harriet dhe John Taylor-in, Thomas Carlyle-n dhe John Sterling-un. Nëpërmjet tyre do të futej në lidhje me shoqërinë e Apostujve të Kembrixhit, një prej

shoqërisë më influencuese të Anglisë së asaj kohe, deri në kohën e J. M. Keynes-it (ku kishte qenë anëtar). Në gjithë ciklin e tij jetësor, Mill kishte rënë në kontakte që nga filozofët radikalë të viteve 1820, me romantikët, me sensimonistët, unitaristët dhe apostujt e Kembrixhit, me burokratët e rinj dhe filozofët radikalë të viteve 1830, duke qenë herë në qendër të vëmendjes dhe herë në periferi, por gjithnjë një person prezent në debatet intelektuale të kohës. Do të ishte në fund të jetës së tij që do të izolohej nga këto klube influencuese, pas martesës së tij me Harriet Taylor-in, pas vdekjes së të shoqit të saj, John Taylor. Nga kjo kohë, ai do të kufizohet në korrespondencat e veta me një rreth të kufizuar miqsh të vjetër si Carlyle dhe August Comte, si dhe do të bëhej një person që do të vazhdohte të influenconte në idetë e një brezi të rinj intelektualësh anglez, përfshi filozofin Spencer. Në vitet 1858-1868 do të ishte anëtar i pavarur i Parlamentit, periudhë që e shfrytëzoi t'i bënte jehonë pikëpamjeve të tij të avancuara liberale, veçanërisht të drejtën e votës për gratë dhe punëtorinë. “Kur kalon nga Quesnay, Turgot dhe Smith, tek Mill-i, menjëherë ndjehet se fillon një epokë e re. Shkenca e ekonomisë e humbet naivitetin dhe thjeshtësinë e kohës së saj të rinisë”, shkruan Prof. Lewis (History of Economic Thought, botim i vitit 1910; fq. 379). Kushtet ekonomike dhe sociale të kohës kishin ndryshuar. Revolucioni industrial i kishte dhënë hov manifakturës dhe



shpikje të reja po revolucionarizonin teknologjitë e prodhimit. Popullsia ishte rritur ndjeshëm; punësitoria po grumbullohej nëpër qytete gjithnjë e më të mëdha; pronarët e tokave po përfitonin nga rritja e kërkesës për toka dhe rentat e larta; nevoja për mbrojtje nga qeveria për të shmangur abuzimet, ishte më e madhe. Që nga koha e Jean-Jacques Rousseau-s, i cili predikonte se natyra do t'i bënte vetë të gjithë të kënaqur, realitetet kishin ndryshuar shumë. Në kohën e Mill-it, natyra shihej si një pushtet i pashpirt, prej të cilit kërkohej mbrojtje.

Fusha e interesave shkencore dhe e njohurive të tij, janë në një mënyrë të pazakontë të gjera. Tre janë veprat më të mëdha të tij, "Logjika" (1843), "Shqyrtim i filozofisë së Sër William Hamilton-it" (1865) dhe "Parimet e ekonomisë politike me disa aplikime të saj në filozofinë sociale" (1848), prej të cilave ne do të ndalemi kryesisht te kjo e fundit, që përbën dhe kontributin e tij më të shquar në doktrinën ekonomike. Ndërsa, vepra tjetër "Esë mbi disa çështje të pazgjdhura të ekonomisë politike" merret në fakt më shumë me aspektet teknike të ekonomiksit.

Si ekonomist, Mill-i do të influencohet dhe do i ishte shumë mirënjohës veprës së Ricardos, madje "e ekzagjeronte këtë ndjesi të borxhit ndaj tij", nënvizon Herbert Spencer në biografinë që shkroi për jetën dhe veprën e Mill-it. Siç e thekson vetë Mill-i, Ricardo kishte krijuar shtyllën kurrizore të shkencës së ekonomisë politike; por gymtyrët dhe nyjat lidhëse, muskujt e saj do të ishin veprë e Mill-it. Teoritë e prodhimit, shpërndarjes dhe shkëmbimeve që krijoi Ricardo, ishin hedhur në skicat e veta të përgjithshme dhe linjat kryesore, të cilat shpeshherë duken pa lidhje dhe vështirë të depërtueshme. Mill do të vendoste lidhjet e duhura mes principeve, do t'i qartësonte dhe do iu jepte atyre kuptim. Këto pikëpyetje sqarohen në veprën e tij "Esë mbi çështjet e pazgjdhura në ekonominë politike", një vepër për të cilën Prof. Cherbuliez i Universitetit të Gjenevës do të shkruante se ishte një nga "veprat më të rëndësishme dhe më origjinale në shkencën e ekonomisë". Megjithatë, Schumpeter nuk e klasifikon veprën e tij, "Parimet", si një vepër rikardiane. Sipas tij, besimi që vetë Mill kishte se ai ishte një rikardian, ishte i gabuar. Teoria e vlerës dhe kostos, që ka një vend qendror tek çdo ekonomist, siç do ta shohim dhe më poshtë në këtë shkrim, tek Mill qëndron si një kompromis midis teorisë së Ricardo-s dhe të Say-t.

Veprën e tij Mill e organizoi në pesë libra: "Prodhimi", "Shpërndarja", "Shkëmbimi", "Ndikimi i progresit të shoqërisë mbi prodhimin dhe shpërndarjen", dhe "Mbi ndikimin e qeverisë". Libri i fundit i dedikohet kryesisht financave publike. Në librin e katërt, ai ndalet në temën e evolucionit ekonomik. Ndërsa tre librat e parë janë një përpjekje për të përmirësuar teorinë e Say-t

në fushat respektive. Duke e vendosur teorinë qendrore ekonomike, atë të vlerës, në librin e tretë, në fakt ai e ndan prodhimin dhe shpërndarjen nga paraja dhe vlera. Në gjykimin shumpeterian, ky është një demonstrim i një dobësie të qartë nga pikëpamja e ndërtimit klasik të analizës ekonomike, në kuptimin që si ekonomist klasik, ai nuk i kishin dhënë një vend qendror teorisë së vlerës, që përbën ndoshta një nga temat fundamentale të kësaj disipline. Pesë librat paraprihen nga "Vërejtjet paraprake", ku Mill, në traditën smithiane, zhvillon idetë e tij mbi evolucionin e shoqërisë ekonomike. Faktorët përcaktues të këtij evolucion shkojnë që nga mjedisi, raca, struktura klasore, si dhe zakonet dhe traditat. Ndërsa "dijen" Mill e trajton edhe si pasojë edhe si shkak të gjendjes së prodhimit dhe shpërndarjes së pasurisë. Në këtë kuptim, Mill vlerëson si faktor parësor të zhvillimit kushtet objektive dhe më pak theks kanë idetë apo principet.

Prej këtej vijon edhe trajtimi që ai i bën kuadrin institucional brenda të cilit zhvillohen proceset ekonomike. Në këtë pikë, J. S. Mill besonte se njeriu mundet dhe duhet ta ndryshojë sistemin kapitalist duke reformuar ato që ai i perceptonte si defekte apo dobësi të tij. Kjo shënon dhe një nga debatet më kontraverse lidhur me veprën e Mill-it. Ludwig von Mises dhe Hayek, por dhe të tjerë, duke analizuar kritikën që Mill-i i bënte sistemit kapitalist, e kanë cilësuar atë si mbështetës të socializmit. Në fakt, Mill i ka bërë një kritikë të fortë institucionit të pronës private për shkak se mbitheksimi i "interesit privat" mund të prodhonte ndryshime të thella sociale. Pabarazitë sociale do të thelloheshin për shkak të relacioneve midis punës/pagës dhe kapitalit. Zgjdhja më e mirë në afat të gjatë, sipas Mill-it, ishte një perfeksionim më i mirë i sistemit të pronës private, duke zbatuar skema më të ndershme të ndarjes së vlerës midis punës dhe kapitalit, sipas një skeme më shumë kooperative. Pikërisht për këtë tezë, Mises do ta quante Mill si "avokatin më të fortë të socializmit". Ndërsa, Schumpeter do të shkante dhe më tej, duke e vlerësuar atë vetë si një socialist.

Në veprën e tij të botuar pas vdekjes, "Kapitujt mbi socializmin", ai shkruan: "Socializmi i adoptuar në një mënyrë të tillë [nëpërmjet revolucionit – shënimi im], do të ishte një dështim katastrofik dhe apostujt e tij nuk do të kishin ngushëllim tjetër, përveçse sistemi që ekziston tashmë si i tillë, do të pushonte së ekzistuar, dhe të gjithë përfituesit prej tij do të rrënoheshin – një ngushëllim që për disa syresh ndoshta është real, pasi nëse i besojmë dukjes, parimi lëvizës i shumicës së revolucionarëve socialist është urrejtja; një urrejtje që duke u shfajësuar nga urrejtja prej dajve të sistemit ekzistues, i hap rrugën një fundi të sistemit ekzistues me çdo çmim, edhe në dëm të atyre që vuajnë prej tij, me shpresën se prej këtij

kaosi, do të lind një jetë (Kozmos) më e mirë, në një padurueshmëri trishtuese për të respektuar përmirësimet graduale të sistemit" (Cituar nga Hollander, 1985, fq. xx).

Në fakt, tre kapituj mbi socializmin që u botuan pas vdekjes nga thjeshtja e tij, më tepër se një libër i plotë, janë skica të një libri kritik mbi gjendjen e socializmit anglez dhe francez të kohës që kishte planifikuar të shkruante por që nuk arriti ta përfundonte. Sidoqoftë, është i ditur dhe i pranuar fakti se Mill nuk kishte një shije të mirë për sistemin shoqëror të kohës dhe shfaqte shumë simpati në favor të klasës punëtore, duke besuar tek evolucionin e sistemit ekonomik drejt një shoqërie socialiste. Mesa duket, ishte ndikuar shumë nga teoritë e Sen Simon dhe socialistëve (utopik) francez.

Një tjetër çështje e një debati të përhershëm që vazhdon në shkencën e ekonomisë është ajo lidhur me metodën, ku spikasin kundërshtitë midis Mill-it dhe një prej ekonomistëve më të mëdhenj të kohës së tij, Nassau Senior. Ndërsa Senior do të vazhdonte të kultivonte mbi traditën e themeluesve të prakseologjisë, Mill mbeti një pozitivist, duke besuar tek "njeriu ekonomik" – njeriu që është i interesuar vetëm pas aspekteve materiale dhe pasurore – një metodë që edhe pse akoma dhe sot vazhdon të jetë thelbësishme e kritikueshme, pasi u ngrit në dominancën e vet në saj të Pareto dhe Friedman, vazhdon të mbetet gjerësisht e përdorur në teorinë ekonomike.

Analiza klasike e procesit ekonomik e vendoste individin/agentin ekonomik individual, si pjesëtar të një klase: pronarë tokash, punëtor dhe kapitalist. Kontributi i veçantë i J. S. Mill është se për herë të parë, në literaturën ekonomike angleze, ai shton dhe një agent tjetër: sipërmarrësin. Roli i sipërmarrësit ishte zhvilluar përciptazi kryesisht në Francë me Cantillon dhe më vonë me Say, dhe po ashtu gjendet përciptazi edhe tek A. Smith (me terma të tillë si herë sipërmarrësi, herë masteri, e herë tregtari), por, edhe në analizën me të thelluar të Say, funksioni i sipërmarrësit ishte konsideruar ai i kombinimit të faktorëve të prodhimit në organizmin prodhues.

Triadës së agjentëve ekonomik i korrespondon dhe triada e shpërndarjes së vlerës: renta mbi tokën, paga dhe kapitali/interesi. Siç e kemi theksuar dhe në Esetë e shkruara më parë mbi ekonomistët klasik, kjo lloji analize e vlerës ishte baza e teorisë marksiste të mbivlerës. Kjo teori e vlerës nga puna e cila nuk u kapërcye as nga Ricardo; do të ishin jorikardianët dhe antirikardianët – Say, Turgot, dhe më pas Carl Menger dhe Ludwig von Mises të shkollës austriake, që do të zhvillonin një teori të ndryshme nga klasikët. Në modelin teorik të shpjegimit të proceseve ekonomike, Mill nuk shkoi më larg se paraardhësit e tij në konceptimin e gjendjes sta-

cionare të ekonomisë. Megjithatë, siç nënvizon Schumpeter, "ai arriti më mirë se të tjerët të bënte dallimin midis gjendjes stacionare si një materializim në të ardhmen i kushteve të sotme të ekonomisë, dhe stacionaritetit si një konstrukt konceptual apo një instrument analize që shërben për të izoluar, për qëllime studimore, grupin e fenomeneve ekonomike që do të vëzhgoheshin në një mjedis të pandryshuar" (fq. 562). Këtu "stacionariteti" përdoret si një abstragim, si një mjet i analizës ekonomike.


Në analizën e vlerës, edhe Mill dallon tre klasa produktesh. Produktet, oferta e të cilave është e kufizuar, vlera/çmimi varet nga raportet e kërkesës dhe ofertës. Ligji i Say-t është parimi i pranuar në përcaktimin e çmimit të mallrave. Në klasën e dytë të mallrave, atë të mallrave që varen nga "puna dhe shpenzimet", e prandaj dhe oferta e tyre mund të rritet pambarimisht, Mill bën dallim midis vlerës normale dhe asaj të tregut, dhe ku ai kërkon ligjësi të ndryshme nga ai i kërkesë-ofertës në përcaktimin e vlerës. Si pikën normale të vlerës ai merr koston e prodhimit. Në këtë kategori mallrash, prodhimi/oferta tenton të rritet deri në pikën kur fitimprurja fillon të ulet. Pikërisht tek analiza e kostos, ai adopton qasjen inovative nga klasikët pararendës duket përfshirë sipërmarrësin si element të saj. Ndërsa në kategorinë e tretë të mallrave, të cilat mund të rriten indefinitivisht, por me një rritje joproportionale të kostove, siç janë prodhimet bujqësore, Mill thotë shumë pak.

Një nga kontributet e Mill-it ishte dhe zhvillimi i mëtejshëm i teorisë rikardiane të tregtisë ndërkombëtare, duke nënvizuar se në tregtinë ndërkombëtare nuk janë të rëndësishme diferencat absolute të kostove të prodhimeve, por diferencat relative të tyre. Nën një zgjerim të argumentit rikardian, Mill shkon më tej kur nënvizon se ligjësia që vlerat permanente varen nga

kostot e prodhimit, nuk qëndron për mallrat e huaja. Më shumë se nga kostoja e prodhimit, vlera e tyre varet nga vlera e mallrave me të cilat ato shkëmbehen. Pra, vlera e tyre i nënshtrohet një ligjësie të ekuacionit të kërkesës botërore.

Pa hyrë në detajet teorike të vizionit të J. S. Mill-it lidhur me zhvillimin ekonomik të shoqërisë, thjesht po nënvizojmë se ai ishte krejt i ndryshëm nga vizioni pesimist i Malthusit, Ricardos dhe i të atit, James Mill-it. Megjithatë, optimizmi i tij buronte nga fakti se popullsia do ta kuptonte teorinë e Maltusit dhe do të vetëkufizonte rritjen e saj, duke bërë që gara midis kapitalit dhe punës, të fitohej nga kapitali.

"Nëse Adam Smith ishte babai i ekonomisë politike", shkruante Lewis, "John Stuart Mill është trashëgimtari i tij". Megjithë kufizimet dhe dobësitë e veprës së tij, nuk ka dyshim se doktrina ekonomike dhe e filozofisë sociale që ai themeloi, ishin shumë më të thella se ajo e pararendësve dhe mbetën dominuese në Angli dhe në komunitetin intelektual botëror. Tipari ndoshta më i spikatur i personalitetit të tij ishte pranueshmëria e ideve të të tjerëve, armiqësia e tij me dogmatizmin. Erudicioni i tij mahnitës është frymëzim për çdo studiues të intelektual. Profesor Henry Fawcett, në esenë e Spencer-it kushtuar J.S. Mill, shkruan: "Disa vite më parë qëllova të ndodhesha në një bashkëbisedim në Cambridge me tre personalitetet më të shquara të matematikës, klasicizmit dhe psikologjisë. Po diskutonim fjalimin e Z. Mill që kishte mbajtur si rektor i Universitetit St. Andrew. Matematikieni tha se kurrë nuk kishte dëgjuar më parë të shpjegoheshin kaq fuqishëm dhe kaq qartë përfitimet që kishte studimi i matematikës; të njëjtën gjë kishin thënë edhe të dyja eminencat e shkencave të tjera. Nuk besoj se ka homazh më të madh që mund t'i bëhet kujtimit të dikujt, rreth të cilit shumë prej nesh janë kaq shumë të lidhur me aq shumë mirënjohje dhe admirim..."





E jashtëzakonshme

# Zbulohet arsyeja e vdekjes misterioze të “nënës duke qarë”

Arsyeja mbrapa vdekjes së nënës egjiptiane është zbuluar në bazë të shprehjes së fytyrës. Është thënë se arsyeja pse kjo grua ka vdekur ishte një sulm në zemër. Arkeologët kanë bërë shumë hulumtime për ta zbuluar faktin se pse kishte ato shprehje të fytyrës “nëna duke qarë”, por princesha egjiptiane ka vdekur nga një sulm në zemër rreth 3000 mijë vjet më parë. Gruaja vuante nga arteroskleroza e arterieve koronare, një sëmundje e rëndë që bën që arteriet e zemrës të bllokohen dhe ta rrisin mundësinë e një



sulmi fatal. Gjendja e saj raportohet gjithashtu se ndikoi në arteriet e saj koronare të djathtë dhe të majtë, arteriet e qafës, aortën abdominale, arteriet iliac dhe ekstremitet e

poshtme. Princesha ishte zbuluar në Luxor, në vitin 1881, ishte gjetur me shprehje interesante “ekstreme” të fytyrës, gjë që i dërgoi deri në zbulimin e arsyes pse mbeti me atë fytyrë.

## BARSOLETA E DITËS



- Kryeministria dhe qytetari**
- Alo! Me kryeministrinë po flas?
  - Po. Çfarë mund t'ju ndihmoj?
  - Dua të kandidoj për kryeministër. Cilat janë kushtet?
  - Je i çmendur?
  - Po kushte të tjera, a ka?



## Në Kino ABC nuk ka shfaqje



## FOTO E DITES



Ushtria e Kosovës furnizohet me mjete ushtarake nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA).

E rrallë

# Shpikët sistemi i ri për parashikimin e vullkaneve

Shkencëtarët e Zelandës së Re kanë shpikur një sistem të ri alarmi për vullkanet. Kjo shpikje e re, sipas tyre, do të kishte paralajmëruar katastrofën që ndodhi vitin e kaluar në Ishullin e Bardhë. 22 persona kishin vdekur pasi kishte shpërthyer një prej vullkaneve më aktive në vend. Sistemi i ri përdor logaritmet mësuese të makinerive për t'i analizuar informacionet në kohë reale dhe për t'i parashikuar shpërthimet e ardhshme. Kërkimi është publikuar në

gazetën “Nature Communications” javën e kaluar. Një prej shkencëtarëve të përfshirë në projekt ka thënë se sistemi aktual është shumë i ngadaltë për t'i paralajmëruar njerëzit nëpër ishuj. “Sistemi aktual mblodh informacione në kohë reale, por mblidhen në një panel e duhet ta kalojnë një proces ekspertimi që zgjat në kohë”, ka thënë Shane Cronin. Kjo mënyrë parashikimi ishte në rregull para 10 vjetësh por, sipas shkencëtarëve, jo tani.



### DASHI

Kontrollojeni veten, ju që jeni në një lidhje nëse nuk doni që të lindin probleme dhe mosmarrëveshje më vonë. Gjendja e financave nuk do jetë as delikate, por as e shkëlqyer.



### DEMI

Ditë e mbushur me gënjeshtër do të jetë kjo e nesërmja për ata që janë në një lidhje. Asgjë nuk ka për të shkuar si duhet me personin që keni në krah dhe debatet do të jenë të pafundme.



### BINJAKËT

Tensioni do të mbi-zotërojë që në mëngjes dhe deri në orët e mesditës, por mbrëmja do të ndryshojë krejtësisht. Financat do përpiqen t'i mbani të stabilizuara me çdo lloj mënyre. Do të jeni i qetë.



### GAFORRJA

Do të ketë mosmarrëveshje pa fund gjatë kësaj dite në jetën tuaj në çift. Nuk do të hapni rrugë në asnjë moment dhe partnerin kjo do ta mërzhitë më shumë. Beqarët, më në fund, do ta takojnë dikë.



### LUANI

Do të ketë edhe pasion, por edhe konflikte të zjarra nesër në jetën tuaj në çift. Emocionet do të jenë në çdo çast të fuqishme. Në planin financiar duhet t'i shtrëngoni fort shpenzimet.



### VIRGJËRËSHA

Duhet të keni më tepër besim. Do ta shihni se do të ndiheni si në ëndërr. Financat do të jenë të mira. Shlyeni sa më parë borxhet që më pas të mendoni për shpenzimet e nevojshme.



### PESHORJA

Do të keni nevojë për ndryshime juve që jeni në një lidhje, kështu që flisni hapur me partnerin dhe bashkëpunoni së bashku për çdo gjë.



### AKREPI

Do të kaloni një ditë shumë të bukur pranë partnerit tuaj dhe kënaqësitë do të jenë të paimagjinueshme. As vetë nuk e keni menduar më parë se gjërat do t'ju ecnin kaq mirë.



### SHIGJETARI

Ditë mjaft e qëndrueshme dhe emocionuese kjo. Do t'ia kaloni për mrekulli pranë atij që dashuronit dhe nuk do të doni të ndaheni për asnjë çast.



### BRICJAPI

Në përgjithësi jeta juaj në çift do të jetë goxha e qëndrueshme. Në aspektin profesional shfrytëzoni çdo mundësi që do t'ju jepet.



### UJORI

Ka rrezik që t'ia ktheni kurrizin partnerit tuaj nesër dhe të merreni me të tjera çështje të rëndësishme. Ai, në fakt, do të ndihet keq dhe mund të kërkojë ngushëllim diku tjetër.



### PESHQIT

Ndikimi i yjeve do të jetë mjaft i favorshëm nesër për jetën sentimentale të çiftëve. Do të qëndroni më shumë kohë me partnerin dhe do t'i tregoni atij disa detaje më shumë.



## Befason ish-presidenti i Argjentinës, rimartohet me gruan që ishte divorcuar para 30 vjetëve



**T**huajse të gjithë mediat rozë në Argjentinë janë hapur me lajmin, “ish-presidenti Carlos Menem rimartohet javën e ardhshme me ish-bashkëshorten e tij Zulema, 30 vjet pas divorcit”. Carlos sapo ka mbushur 90 vjeç dhe me Zuleman është martuar për herë të parë në vitin 1966. Nga

kjo martesë çifti ka dy fëmijë, Carlitos, i cili ndërroi jetë pas një përplasje me helikopter dhe Zulemita, e cila është në prag të 50-ave. Ish-presidenti dhe Zulema janë njohur në Damask në vitin 1964 dhe nga ai takim gjërat mes tyre avancuan, sa arritën deri te martesja.

## Rita Ora në lidhje serioze me Roman Gavras?



**K**ëngëtarja shqiptare, Rita Ora, ka shijuar një shëtitje gjatë natës në Londër, ndërsa ka zbuluar identitetin e të dashurit të saj të ri. 29-vjeçarja ka thënë se ajo ka filluar romancën me krijuesin e videove muzikore, Roman Gavras, pasi edhe u pa nën shoqërinë e tij, shkruan “Daily Mail”. Krijuesja e hiteve si duket ka dalë për të drekuar disa ditë pasi ajo u kthye

nga ferma në të cilën qëndroi gjatë pandemisë Covid-19. Me një veshje komplet të bardhë, Rita ka mahnitur me dukjen, ndërsa flokët kishte vendosur t'i mbante të lidhura lart kokës. Këngëtarja shqiptare është fotografuar jashtë “Soho House” derisa po bisedonte me miqtë. Imazhet e fundit tregojnë se këngëtarja shqiptare është në një lidhje serioze me Romanin.



## Nicky Minaj në pritje të ëmbël

Reperja e njohur Nicky Minaj përmes një postimi në llogarinë e vet në “Instagram”, ka bërë me dije se është në pritje të bëhet nënë. Ajo ka publikuar një foto me barkun e rrumbullakosur dhe e ka shoqëruar postimin me një zemër të verdhë. Minaj është martuar në vitin 2019 me Kenneth Petty dhe në një postim të hershëm të saj ajo ishte shprehur:

“Unë nuk mendoja se martesja do të ishte kaq qetësuese. Edhe nëse nuk jeni i martuar, kur keni dikë që është pjesë e shpirtit ose dikush që ju kupton, kjo gjë ju bën të ndiheni mjaft mirë”. Prej disa kohësh në mediat rozë ishte përfolur për një shtatzëni të mundshme të reperes, sidomos pasi ajo kishte filluar të shtonte peshë.

## E dashura e Ronaldos, poza provokuese nga jahti luksoz



**E**dashura e futbollistit të njohur Cristiano Ronaldo, Georgina Rodriguez, është mjaft aktive në “Instagram”. Së fundmi, bukuroshja ka ndarë me ndjekësit e shumtë çaste nga pushimet luksoze me familjen. E sigurisht se nuk kanë munguar as fotot provokuese që ajo realizon

herë pas here. Georgina ka postuar në “Instagram” disa poza ku shfaqet në superformë me bikini, teksa qëndron në jahtin luksoz. Me këto poza seksi, e dashura e Ronaldos duket se për një moment ua ka hequr vëmendjen fansave nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Gjilani dhe Ballkani sot luftojnë për fitore

Dy klubet që po e kërkojnë titullin në elitën e futbollit, Gjilani dhe Ballkani, do të përballen sot, me synim që ta marrin maksimumin e pikëve dhe të jenë në garë për titull edhe në ndeshjen e fundit të kampionatit 2019/2020. Krahas kësaj ndeshje, sot (mërkurë) do të zhvillohen edhe katër ndeshje të tjera të javës së parafundit në Superligë



Fiton Hajdari, i cili beson se skuadra e tij do të dalë triumfuese ndaj Ballkanit. Diferenca në mes të Gjilanit dhe Ballkanit është vetëm një pikë. "Ndeshja kundër Ballkanit është vendimtare për të dyja ekipet. Duke e parë rëndësinë e takimit, jemi përgatitur mirë dhe synojmë t'i marrim pikët e plota në këtë ndeshje", ka thënë Hajdari. Ndërsa në stadiumin "Fadil Vokrri" do të zhvillohet përballja mes dy skuadrave nga

kryeqyteti, Prishtinës dhe Flamurtarit. Kjo ndeshje është shumë e rëndësishme për kuqezinjtë të cilët janë në garë për mbijetesë. Në Drenas, Trepça '89 kërkon tri pikët e shpresës për mbijetesë ndaj Feronikelit.

**Drita mposhti Drenicën, 'preku' titullin në Superligë**

Drita e ka mposhtur Drenicën

me rezultat minimal 1-0 në ndeshjen e parafundit të IPKO Superligës së Kosovës në futboll. Klubit gjilanas i mjaftoi goli i vetëm i shënuar nga Xhevdet Shabani në minutën e 48 për t'i marrë tri pikët e plota. Pas kësaj ndeshje, Drita është edhe më afër titullit të kampionit në elitë, pasi tash ka 68 pikë të grumbulluara. Në anën tjetër, Drenica vazhdon të jetë e rrezikuar nga rënia pasi renditet në pozitën e tetë me 41 pikë.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 21 KORRIK** - Derbi në mes të Gjilanit dhe Ballkanit do të zhvillohet sot (e mërkurë) nga ora 17:00. Fitorja është synimi të dyja skuadrave, pasi janë në garë për titull dhe cilado që të dalë triumfuese nga kjo përballje, do ta diskutojë titullin me skuadrën e Dritës.

Drejtori i Ballkanit, Avni Bytyçi, ka thënë për "Epokën e re" se skuadra nga Suhareka është e përgatitur maksimalisht dhe se synon fitore ndaj Gjilanit. "Për hir të së vërtetës ndeshja ndaj Gjilanit do të jetë shumë e vështirë, pasi ka një ekip të mirë sikurse që e kemi edhe ne. Është vështirë të parashikohet rezultati, por jemi optimistë se mund t'ia dalim nëse ka një referim cilësor. Ne kemi një skuadër të re dhe shumë cilësore, derisa mungesa për

këtë ndeshje nuk kemi dhe të gjithë lojtarët janë të gatshëm që ta japim maksimumin", ka thënë Bytyçi.

Për ndeshjen që zhvillohet sot në Gjilan foli edhe futbollisti

### IPKO Superligë

Drita - Drenica	1-0
Gjilani - Ballkani	
Prishtina - Flamurtari	
Feronikeli - Trepça '89	
Llapi - Ferizaj	
Dukagjini - Vushtrria	

Tabela		PINË
1. Drita	32	68
2. Gjilani	31	64
3. Ballkani	31	63
4. Prishtina	31	59
5. Feronikeli	31	44
6. Flamurtari	31	43
7. Llapi	31	42
8. Drenica	32	41
9. Trepça '89	31	38
10. Ferizaj	31	29
11. Vushtrria	31	18
12. Dukagjini	31	16

## KOK-u mbulon shpenzimet e sportistëve elitare të xhudos



**PRISHTINË, 21 KORRIK** - Komiteti Olimpik i Kosovës do t'i mbulojë shpenzimet e gjashtë sportistëve elitare të xhudos të cilët po marrin pjesë në kampin përgatitor në Poreq të Kroacisë. Mbështetja vlen bazuar në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut për mbështetje të sportistëve elitare (sipas kategorizimit të sportistëve) për përgatitje jashtë vendit. Gjashtë

sportistët elitare të xhudos janë: Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Lorian Kuka, Akil Gjakova dhe Laura Fazliu. Nën udhëheqjen e trajnerit Driton Kuka dhe asistentit të grupmoshave të reja, Fatos Tabaku, ekipi prej 13 xhudistëve po përgatitet bashkë me ekipin kombëtar të Kroacisë. Ekipi i xhudos do të përgatitet në Poreq deri më 26 korrik. KOK-u

kishte mbuluar shpenzimet e xhudos edhe për përgatitjet e mbajtura javë më parë në Golem të Shqipërisë. Bordi Ekzekutiv i KOK-ut në mbledhjen e fundit kishte vendosur që shkak i pandemisë Covid-19, sportistëve të kategorizuar t'u mbulohen shpenzimet edhe për përgatitjet në kampet që organizohen në Kosovë ose vendet fqinje të Kosovës.

## Hasi rinovon kontratën me Al Raedin

**BURAYDAH, 21 KORRIK** - Besnik Hasi edhe për një tjetër sezon do të qëndrojë larg Evropës. Trajneri shqiptar ka rinovuar edhe për një tjetër vit kontratën me Al Raed. Puna e mirë që ka

bërë Hasi në klubin e tij në Arabinë Saudite nuk ka mbetur pa u monitoruar nga Fenerbahçe që po e merrte seriozisht në konsideratë idenë e afrimit të tij për edicionin e

ardhshëm. Por klubi arab, pasi insistoi që Hasi të kthehej dhe ta mbyllte sezonin e lënë në mes si pasojë e shpërthimit të pandemisë, duke i dërguar në Belgjikë një avion privat, për ta

marrë bashkë me familjen, i bëri atij një ofertë të përmirësuar financiare në krahasim me atë që kishte përfituar deri tani trajneri. Hasi është pjesë e Al Raedit që nga korriku i vitit






## KB Ylli vazhdon bashkëpunimin me trajnerin Radoviq

SUHAREKË, 21 KORRIK - KB Golden Eagle Ylli ka njoftuar me anë të një postimi në rrjetin social "Facebook" se skuadrës do t'i prijë në sezonin 2020/2021 trajneri

Dragan Radoviq. Në këtë mënyrë skuadra nga Suhareka e ka konfirmuar besimin në trajnerin malazez edhe për një sezon tjetër. "Edhe pse ky pritjet të

jetë një vit i vështirë në të gjitha aspektet, ne do të vazhdojmë me punë aty ku e lamë sezonin e kaluar. Ju njoftojmë se kemi arritur marrëveshje për vazhdimin

e kontratës me trajnerin, Dragan Radoviq, edhe për sezonin e ardhshëm. Kemi edhe shumë për të zbuluar", thuhet në njoftimin e KB Ylli.



## Abdullahu: Debutim me peshë në garat ndërkombëtare

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kosova A (femrat) për herë të parë vitin e ardhshëm do të garojë në arenën ndërkombëtare. Formimi i Përfaqësueses A te femrat dhe pjesëmarrja në garat zyrtare është përkrahur nga komuniteti i basketbollit në Kosovë. Shumë basketbolliste e kanë ëndërruar këtë ditë, por që nuk kanë mundur për shkak të mospranimit në arenën ndërkombëtare. Por, këtë ëndërr do ta jetësojnë gjeneratat e reja.

Ish-basketbollistja e Universitetit të Prishtinës, Teuta Abdullahu, është shprehur se çdo debutim ka peshën dhe rëndësinë e vet. "Çdo debutim në garat ndërkombëtare ka peshën, rëndësinë dhe përgjegjësinë e vet, aq më tepër kur është fjala në nivel të Përfaqësueses. Mundësia për garim në këtë nivel është lajm i mirë dhe premtues për basketbollin femëror, mirëpo mendoj se është edhe mjaft ambicioz, duke konsideruar nivelin e basketbollit femëror në vendin tonë. Jemi dëshmitarë të asaj se sa shumë punë dhe përvujtje në garat ndërkombëtare i nevojitet një ekipi të ketë prezantim të suksesshëm", është shprehur basketbollistja e gjeneratës së artë për faqen zyrtare të FBK-së. "Një kohë të gjatë Përfaqësuesja A te femrat ka qenë në 'gjumë', prandaj kjo më jep një dozë skepticizmi për garat e vitit të ardhshëm, ku pritjet të marrë pjesë. Në anën tjetër, ky lajm u jep motiv



kategorive të reja të cilat janë duke garuar në kategoritë përkatëse. Atyre u është hapur mundësia e garimit ndërkombëtar edhe pasi të arrijnë moshën seniore. Vajzave të Përfaqësueses, ekipit teknik dhe FBK-së, u uroj shumë suksese në këtë rrugëtim me shumë sfida dhe shumë punë para që i presin", ka deklaruar Teuta Abdullahu, e cila me sukses ka luajtur për Universitetin e Prishtinës, duke garuar edhe në Ligën Trocal. Kosova A (femrat) pritjet të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla, që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros

prej 15 deri më 20 qershor. Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që u anulua për shkak të pandemisë Covid-19. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha federatat nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

## Ish-tenisti Juan Monaco: Doja ta 'vrisja' Nadalín kur u tërhoq nga ndeshja

MADRID, 21 KORRIK - Ish-tenisti argjentinas Juan Monaco, në një intervistë për ATP-në, ka folur për miqësinë e fortë që ka me Rafael Nadalín, një miqësi që është forcuar me kalimin e viteve. Tenisti amerikano-latin ka folur për takimet e para me Nadalín, që nisën pas ndeshjes së parë që ata zhvilluan në vitin 2005. "Luajtëm për herë të parë në turneun e Bastad, në Suedi, ku më mundi me shumë lehtësi 2-0 (6-1, 6-1). Pasi përfunduam atë turne, ikëm së bashku në Spanjë, në shtëpinë e tij. Qëndruam aty një javë. Që në atë moshë (19 vjeç) ishte i jashtëzakonshëm, i destinuar të bëhej i madh dhe e kisha shumë mik", ka thënë Juan Monaco. Monaco e ka mposhtur vetëm një herë Nadalín në karrierën e



tij, në vitin 2007, në turneun e Sinsinati, ndeshje të cilën spanjollit nuk e përfundoi, pasi u tërhoq, i dëmtuar në fundin e saj. "Isha i inatosur me Rafaelín pasi nuk donte ta mbyllte atë ndeshje kur po fitoja 7-6, 4-1.

Doja ta 'vrisja'. Isha i lumtur për fitoren, por nuk do t'i kishte kushtuar asgjë po të luante edhe disa minuta më shumë dhe ta merrja një tore të vërtetë, jo me tërheqje të tij", ka shtuar Monaco.

### SHKURT

#### Bie vlera e Rashicës

Milot Rashica është në pritje të finalizimit të largimit nga Werder Bremeni. Ylli i Kosovës spekulohet se do të transferohet në Leipzig gjatë afatit kalimtar të verës. Në ndërkohë, rezultatet e dobëta të ekipit gjatë këtij sezoni në Bundesligë duket se kanë ndikuar të zbrësë vlera e Rashicës në treg. Rashica e nisi sezonin me vlerë prej 20 milionë eurove në treg që, megjithatë, u ngrit në 35 milionë euro pas paraqitjeve të tij të mira, kur i shënoi shtatë gola në pjesën e parë të sezonit. Megjithatë, tani vlera e tij ka rënë sërish në 22 milionë euro, sipas "Transfermarkt.de". Leipzigu spekulohet se ka ofruar 15 milionë euro për shërbimet e Rashicës, por Werderi thuhet se kërkon më tepër për shitjen e tij.

#### Sulejmani rikthehet te Hannoveri

Valmir Sulejmani ka bërë një hap të rëndësishëm në karrierën e tij futbollistike, pasi nga klubi i kategorisë së tretë në futbollin gjerman, Waldhof Mannheim do të rikthehet te Hannoveri. Sulejmani ka luajtur për Gjermaninë U-17, ndërsa më pas ka luajtur me shumë sukses te U-21 e Kosovës. Ka disa ndeshje edhe me Përfaqësueses A të Kosovës.

#### Sarri: Ronaldo është i jashtëzakonshëm kur ndien aromën e titullit

Cristiano Ronaldo ka shënuar dy golat e fitores për Juventusin në derbin ndaj Lazios (2-1). Trajneri Maurizio Sarri e ka lavdëruar yllin portugez për paraqitjen e bërë, duke thënë se ai është i jashtëzakonshëm kur e ndien aromën e titullit. "Kur Ronaldo ndien aromën e titullit është i jashtëzakonshëm. Nga njëra ndeshje në tjetrën ka një rikuperim fizik dhe psikologjik fantastik", ka thënë Sarri. Trajneri italian ka thënë se "Zonjës së Vjetër" i duhen edhe katër pikë në katër ndeshje për ta fituar "Scudetton".

#### Kukësi, afër transferimit të Jashanicës

Kukësi është në kërkim të mbrojtësit nga Kosova, Bajram Jashanica, i cili aktivizohet me Skënderbeun e Korçës. Lajmi konfirmohet nga "Panorama". Mbrojtësi i Skënderbeut, Bajram Jashanica, është një synim i kahershëm i skuadrës së Kukësit, madje afrimi i tij në kampin verilindor ishte thujtë i kryer para se 29-vjeçari të pezullohej nga FIFA për shkak të përdorimit të substancave të ndaluara. Mësohet se me t'u mbyllur kampionati, Jashanica do t'i bashkohet skuadrës kuksiane, pasi duket se janë gjetur edhe termat ekonomikë dhe palët kanë rënë dakord për një bashkëpunim për të paktën sezonin e ardhshëm. Jashanica më parë ka qenë pjesë edhe e Përfaqësueses së Kosovës.

#### Boateng: Dua të pensionohem në Bayern

Mbrojtësi i Bayern Munchen, Jerome Boateng, është një nga lojtarët më të përfolur për largim në secilin afat kalimtar. Mirëpo, 31-vjeçari e ka mohuar se do të largohet nga Bayerni, duke bërë me dije se është i interesuar të pensionet në këtë klub. "Nuk e kam menduar kurrë një largim nga Munihu. Bayerni është shtëpia ime. Dua të qëndroj sa më gjatë këtu, mundësisht të dal në pension në këtë skuadër. Këtu kam bërë histori dhe shpresoj që të vazhdoj të bëj. Kam edhe një vit kontratë dhe shpresoj të rinovoj sërish. Nuk kam folur ende me drejtuesit", ka deklaruar Boatengu, i cili me Bayernin ka regjistruar 200 paraqitje.

#### Benzema zgjedhet lojtari i sezonit në Spanjë

Media spanjolle e futbollit ka zgjedhur sulmuesin e Real Madridit, Karim Benzema, si "Futbollistin e sezonit 2019-2020 në La Liga". Francezi ka siguruar 36% të votave. Kontributi për titullin e 34-të kampion të Spanjës me 21 gola dhe 8 asistime është çmuar më i rëndësishëm se 25 golat dhe 21 asistimet e Lionel Messit me Barcelonën. Në vendin e tretë renditet kapiteni i Realit, Sergio Ramos, me 14% të votave. Edhe pse Messi u shpall golashënuesi më i mirë, kjo duket se nuk ka mjaftuar që tifozët ta përzgjedhin "pleshtin".





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit*  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
*Ministry of Economy and Environment*

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**  
**për Kushtet Ndërtimore**

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 1461/20 të datës 12.02.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomandë:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
 Ndërtesa e Rilindjes  
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
 Suzana.goranci@rks-gov.net  
 Telefon: + 381 38 200 32 553

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Egzon Shala shpall të pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

► Jashar Geshtej shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Festa Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Emin Duraku" Prizren.

► "Bitter Farbwerke" SH.P.K. shpall të pavlefshme Certifikatën e Biznesit me nr. 810866494, Fushë Kosovë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

**Lume's Details**  
**Estetik & Depilim**

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Bujar Kacamaku & Edon Fishekqiu” O.P. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 810957772, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bujar Kacamaku & Edon Fishekqiu”, O.P. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810957772, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Bujar Kacamaku & Edon Fishekqiu” O.P. has come to the decision to quit its business: 810957772 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Autovegla Kosova” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB:811386532, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Autovegla Kosova”, D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 811386532, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Autovegla Kosova” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811386532 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# PASHTETË PULË

gluten  
free



*cilësi e garantuar*

pa konservues